



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RREGULLORE

Nr. 10 , Date 11. 08. 2009

PER

CAKTIMIN DHE PERDORIMIN E NUMRAVE

DHE SERIVE NUMERIKE

Kapitulli I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1 Objekti

1. Kjo rregullore përcakton planin e numeracionit, të drejtat dhe detyrat për përdorimin e numrave dhe serive numerike të planit të numeracionit dhe procedurat për dhënien e së drejtës për përdorimin e numrave dhe serive numerike, mbështetur në nenet 80 deri në 90 të ligjit 9918 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Kjo rregullore zbatohet ndaj të gjithë numrave dhe serive numerike të përdorura në rrjetet dhe shërbimet e komunikimit publik, të cilat ofrohen në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2 Objektivat

Gjatë administrimit të planit të numeracionit dhe dhënies së të drejtës për të përdorur numra dhe seri numerike të planit të numeracionit, AKEP do të ndjekë objektivat e mëposhtme:

- a) të garantojë përdorimin efikas të numrave dhe serive numerike;
- b) të plotësojë nevojat e arsyeshme të operatoreve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike për caktimin e numrave dhe serive numerike;
- c) të zbatojë procedura të pa-anshme, transparente dhe jo diskriminuese;
- d) të ndjekë parimin e neutralitetit të teknologjisë;
- e) të mbrojë interesat e përdoruesve, në vecanti të përdoruesve fundorë, të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Facilitete shoqëruese” janë facilitetet e lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike dhe/ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti ose shërbimi.
2. “Identifikimi i linjës thirrëse” është funksioni që, në bazë të numrit ose kodit të caktuar për pikën fundore të rrjetit, i mundëson pajtimtarit marrës të thirrjes të identifikojë pikën fundore të rrjetit, ku wshtw origjinar thirrja.
3. “Numër” është një seri alfa-numerike e përcaktuar në planin e numeracionit, që shërben për adresim në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.
4. “Kodi i shkurtër” do të thotë një numër me tre deri gjashtë shifra;
5. “Kod numeracioni” është një numër apo një kombinim numrash pa prefiksin kombëtar “0”, i cili karakterizon zonën e numeracionit të thirrur. Nëse plani kombëtar i numeracionit është “i hapur” dhe kur pajtimtari thirrës dhe ai i thirrur u përkasin zonave të ndryshme të numeracionit, ky kod formohet përpara numrit të pajtimtarit të thirrur.
6. “Numër gjeografik” është një numër kombëtar, i cili i përket një zone gjeografike të caktuar.

7. “Numrat jo-geografikë” janë numrat kombëtarë, që nuk i përkasin një zone gjeografike të caktuar dhe përfshijnë:
 - a) numrat për akses në rrjetet publike të lëvizshme të komunikimit;
 - b) numrat për akses në shërbimet me vlerë të shtuar;
 - c) numrat për akses në shërbimet, për të cilat e gjithë tarifa për trafikun drejt këtyre shërbimeve paguhet nga ofruesi i shërbimeve, pra drejt numrave që janë pa pagesë për përdoruesit (numra pa pagesë, numrat jeshil);
 - ç) numrat për akses në shërbimet, për të cilat tarifa për trafikun drejt këtyre shërbimeve paguhet pjesërisht nga thirrësi dhe pjesërisht nga ofruesi i shërbimit, pra drejt numrave, të cilët i janë dhënë përdoruesit përkundërt një marrëdhënie të paracaktuar (numra me ndarje të kostos, numër blu);
 - d) numrat për shërbim publik telefonik nomadik.
8. “Numër kombëtar” do të thotë një numër i planit kombëtar të numeracionit të Republikës së Shqipërisë sic përkufizohet në kapitullin 2 të kësaj rregulloreje.
9. “Numrat e shërbimeve të emergjencës” janë numrat e përcaktuar në planin e numeracionit për shërbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike për policinë, zjarrfikësit, numrat e emergjencës për shërbimet shëndetësore, shërbimet lajmëruese dhe ato të deklaruara, që përfshihen në numrin e harmonizuar europian “112”.
10. “Operator i rrjetit të komunikimeve publike” është sipërmarrësi, i cili ka të drejtë të ndërtojë, të posedojë, të japë me qira dhe të shfrytëzojë një rrjet të komunikimeve publike dhe facilitetet shoqëruese, si dhe të ofrojë shërbime të komunikimeve publike.
11. “Ofruesi i shërbimit të komunikimeve publike” është sipërmarrësi që ofron shërbime komunikimi publike, duke siguruar akses te një operator i rrjetit të komunikimeve publike.
12. “Pajtimtar” është cilido që ka lidhur një kontratë me një sipërmarrës që ofron shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun, për përfitimin e shërbimeve të ofruara.
13. “Pika fundore e rrjetit” është pika fizike, në të cilën një pajtimtar ka akses në rrjetin e komunikimeve publike. Në rastin e rrjeteve, që përfshijnë komutimin ose rrugëzimin pika fundore e rrjetit identifikohet si një adresë specifike e rrjetit, e cila mund të lidhet me numrin ose emrin e një pajtimtari.
14. “Plani i numeracionit” është struktura e numrave dhe e serive të numrave, si dhe caktimi i tyre për sigurimin e aksesit në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve publike.
15. “Plani i numër-formimit” do të thotë rregullat se si mund të thirren numrat e planit të numeracionit në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike;
16. “Rrjet i komunikimeve elektronike” janë sistemet e transmetimit dhe, nëse ekzistojnë, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin), rrjetet e lëvizshme tokësore, sistemet e kablove elektrike në raste kur ato përdoren, për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive, pavarësisht nga tipi i informacionit të përcjellë.
17. “Rrjet i komunikimeve publike” është një rrjet i komunikimeve elektronike, që përdoret, tërësisht ose pjesërisht, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun.
18. “Rrjet i qëndrueshëm (fiks) i komunikimeve publike” është rrjeti, në të cilin pikat fundore janë të vendosura në vende të fiksuara.
19. “Rrjet i lëvizshëm i komunikimeve publike” është rrjeti, në të cilin pikat fundore nuk janë të vendosura në vende të fiksuara.
20. “Seri Numerike” nënkupton një grup numrash që fillon me të njëjtat shifra, në vecanti, një grup prej 1000 ose 10000 numrash;

21. “Shërbim i komunikimeve elektronike” është shërbimi, normalisht përkundrejt një pagese, i cili përftohet, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike, që përfshin shërbimet e telekomunikacioneve dhe shërbimet e transmetimit në rrjetet e përdorur për transmetime radiotelevizive dhe në rrjetet e televizionit kabllor, por duke përfshirë shërbimet, të cilat ofrojnë përmbajtje nëpërmjet rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, ose që ushtrojnë kontroll redaksional ndaj përmbajtjes së ofruar për transmetimin, duke përdorur rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike. Ai nuk përfshin shërbimet e shoqërisë së informacionit, të cilat nuk përbëhen, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve në rrjetet e komunikimeve elektronike.
22. “Shërbim i komunikimeve elektronike” është shërbimi, normalisht përkundrejt një pagese, i cili përftohet, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike;
23. “Shërbim publik telefonik nomadik” është shërbimi publik telefonik i ofruar për përdoruesit nëpërmjet një rrjeti të komunikimeve elektronike, ku pajisjet fundore të përdoruesit lidhen me pikat fundore të rrjetit të qëndrueshëm, të cilat mund të ndodhen në njësi gjeografike të ndryshme.
24. “Shërbim telefonik i disponueshëm për publikun” është një shërbim i disponueshëm për publikun për origjinimin dhe marrjen e thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe aksesin në shërbimet e emergjencës nëpërmjet një ose më shumë numrave në një plan numeracioni telefonik. Ky shërbim mund të përfshijë ofrimin e një ose më shumë nga shërbimet e mëposhtme:
 - a) shërbimin e operatorit;
 - b) rubrikën e shërbimeve të kërkimit të informacionit, numeratorin telefonik;
 - c) ofrimin e telefonave publikë me pagesë;
 - ç) shërbimet në kushte të veçanta, sipas përcaktimeve në pikën 3 të nenit 27 të këtij ligji;
 - d) ofrimin e pajisjeve fundore të veçanta të telekomunikacioneve për konsumatorë me aftësi të kufizuara ose nevoja sociale të veçanta;
 - dh) aksesin në shërbimet me numra jogjeografikë.
25. “Shërbim me vlerë të shtuar” është shërbimi që ofron informacion, përkundrejt pagesës, nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit.
26. “Sipërmarrës” është çdo person fizik, juridik i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, i cili ofron rrjete të komunikimeve elektronike ose shërbime të komunikimeve elektronike.
27. “Zone numeracioni gjeografike” është një rajon gjeografik i përcaktuar, i cili ka një kod të caktuar numeracioni;

Kategoritë e ndryshme të numrave të planit të numeracionit janë përcaktuar në Kapitullin II të Rregullores

Neni 4 Ndërveprimi

1. Të gjithë operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve publike që përdorin numra dhe seri numurike të planit të numeracionit duhet të garantojnë ndërveprimin. Në përgjithësi, të gjithë pajtimtarëve që përdorin një numër nga plani i numeracionit duhet t’ju krijohet mundësia të thërrasin të gjithë numrat e planit të numeracionit dhe të dergojnë e të marrin thirrje ndërkombëtare.
2. Operatorët mund të kufizojnë mundësinë e ndërveprimit nëse pajtimtarët nuk dëshirojnë të thërrasin seri të caktuara numrash ose nuk dëshirojnë të thirren nga disa seri të caktuara numrash.

Neni 5 Identifikimi i linjës thirrëse (CLI)

1. Të gjithë operatorët e rrjeteve telefonikë publike dhe shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun kanë detyrimin të transmetojnë Identitetin e Linjes Thirrëse (CLI), edhe nëse është aktivizuar shërbimi i kufizimit të identifikimit të linjës thirrëse (CLIR).
2. Operatori në rrjetin e të cilit origjinohet thirrja (operatori origjinues) do të përdoret si CLI një numër në përputhje me planin e numeracionit dhe që i është alokuar pajtimtarit të linjës thirrëse. Nëse një pike fundore të rrjetit i është caktuar me shumë se një numër, si informacion për linjën thirrëse, për thirrjet drejt shërbimeve të urgjencës duhet të përdoret numri i cili ofron informacionin më të mirë për vendndodhjen.
3. Operatori origjinues duhet të vendosë informacionin për CLIR sipas kërkesës së pajtimtarit të linjës thirrëse. Pajtimtari duhet të ketë mundësinë të aktivizojë ose të çaktivizojë CLIR për të gjitha thirrjet dalese ose për një thirrje të veçantë.
4. Operatori origjinues mund të përdoret vetëm një fushë boshe si CLI nëse është teknikisht e pamundur të përcaktohet se nga cili numër është origjinuar thirrja ose nëse pajtimtari thirrës nuk ka një numër. Nëse është teknikisht e mundur të përcaktohet CLI sipas pikës 2 të këtij neni, por është e pamundur të aplikohet pika 3 e nenit, operatori origjinues do të sigurojë CLI dhe të aktivizojë CLIR për të gjitha thirrjet dalese.
5. Operatori që përcjell thirrjen nga njëri rrjet në tjetrin (operator tranzit) në asnjë rast nuk duhet ta ndryshojë ose ta fshijë informacionin e marrë në fushat e CLI dhe CLIR, por duhet ta përcjellë këtë informacion të paprekur. Operatorët të cilët marrin thirrje ndërkombëtare duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të marrë informacionin e saktë për CLI dhe CLIR nga partnerët e huaj me të cilët interkonektohen.
6. Operatori në rrjetin e të cilit thirrja do të terminojë (operatori terminues) interpreton informacionin në fushën e CLIR dhe në përputhje me nenet 103 dhe 125 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, dhe vendos nëse duhet t'ja njoftojë CLI pajtimtarit të thirrur.
7. Të gjithë operatorët duhet të respektojnë, për aq sa është teknikisht e mundur, rekomandimet përkatëse të ITU dhe Udhezimin (02)051 të ETP (European Telecom Platform) për CLI

Kapitulli II

Plani i numeracionit

Neni 6 Struktura e planit të numeracionit

1. Plani i numeracionit përmban kategoritë e mëposhtme të numrave:
 - a) numra gjeografikë:

N_1	S_1	S_2	S_3	S_4	S_5	S_6	S_7
-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------

ku: $N_1=4$;

$S_1=2 \div 6$;

$S_2 \div S_7=0 \div 9$;

ose:

N_1	N_2	S_1	S_2	S_3	S_4	S_5	S_6
-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------

ku: $N_1=2 \div 5, 8;$ $S_1=2 \div 9;$
 $N_2=2 \div 5, 7 \div 9;$ $S_2 \div S_6=0 \div 9;$

ose:

N_1	N_2	N_3	S_1	S_2	S_3	S_4	S_5
-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------

ku: $N_1=2, 3, 5, 8;$ $S_1=2 \div 9;$
 $N_2=1, 6 \div 9;$ $S_2 \div S_5=0 \div 9;$
 $N_3=0 \div 9.$

(shih Shtojcen 1)

b) numra të lëvizshëm:

N_1	N_2	S_1	S_2	S_3	S_4	S_5	S_6	S_7
-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------

ku: $N_1=6;$ $S_1=2 \div 9$
 $N_2=2 \div 9;$ $S_2 \div S_7=0 \div 9$

ose:

N_1	N_2	N_3	S_1	S_2	S_3	S_4	S_5	S_6
-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------

ku: $N_1=6;$ $S_1=2 \div 9$
 $N_2=1;$ $S_2 \div S_6=0 \div 9$
 $N_3=0 \div 9;$

c) Kode te shkurter te harmonizuar europiane (HESC):
11X dhe 19X (ku: $X=0 \div 9$)

ç) numra të urgjencës:

112, 125, 126, 127, 128 dhe 129

d) numra për shërbime sociale të harmonizuara:

116 X₁X₂X₃; (ku: $X_1, X_2, X_3=0 \div 9$);

dh) numra për shërbime të informacionit :

118 X₁X₂; (ku: $X_1; X_2=0 \div 9$);

e) kode të shkurtër për shërbimet e operatorit :

122, 123, 124;

13Y, 14Y (ku: $Y=0 \div 9$);

165, 189Y (ku: $Y=1, 2$)

ë) numrat personalë :

7	0	0	S_1	S_2	S_3	S_4	S_5
----------	----------	----------	-------	-------	-------	-------	-------

ku: $S_1=2 \div 9$
 $S_2 \div S_5=0 \div 9$

f) numra të thirrjes dial-up:

717 X₁ X₂ X₃ X₄; (ku: X₁=1 ÷ 9 dhe X₂, X₃, X₄=0 ÷ 9)

g) numra të gjelbër:

800 X₁ X₂ X₃ X₄ (ku: X₁, X₂, X₃, X₄=0 ÷ 9)

gj) numra për kartat telefonike:

801 X₁ X₂ X₃ (ku: X₁=1 ÷ 9 dhe X₂, X₃=0 ÷ 9)

h) numra blu:

808 X₁ X₂, X₂; (ku: X₁=1 ÷ 9 dhe X₂, X₃=0 ÷ 9)

i) numra për shërbimet me vlerë të shtuar:

900 X₁ X₂ X₃; (ku: X₁=1 ÷ 9 dhe X₂, X₃=0 ÷ 9)

j) kode të shkurtër për shërbimet SMS me vlerë të shtuar:

5 X₁ X₂ X₃ X₄ (ku: X₁, X₂, X₃, X₄=0 ÷ 9)

2. Plani numërformimit është një plan i hapur. Përdoruesit përdorin gjithmonë prefiksin kombëtar "0", përveç se kur thërresin kode të shkurtër që fillojnë me "1" ose destinacionet lokale në të njëjtën zonë gjeografike. Plani i numërformimit përmban kategoritë e mëposhtme të numrave:

a) prefiksi kombëtar : **0**;

b) prefiksi ndërkombëtar: **00**;

c) prefikset për zgjedhjen e bartësit:

10 X₁ X₂ (ku: X₁, X₂=0 ÷ 9)

ç) kodet e rrugëzimit për portabilitetin e numrit:

99 X₁ X₂ (ku: X₁, X₂=0 ÷ 9)

3. Të gjithë numrat që nuk janë përfshirë në këtë kapitull të rregullores rezervohen për përdorim të ardhshëm dhe nuk duhet të përdoren në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve publike.

Neni 7

Detyrime të përgjithshme

1. Të gjithë operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve publike në Republikën e Shqipërisë duhet t'i përdorin numrat dhe serite numerike vetëm në përputhje me planin e numeracionit sic përcaktohet në këtë rregullore.

2. Operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve jo publike mund të përdorin numra të tjerë brenda rrjeteve dhe shërbimeve të tyre, por duhet të përdorin planin e numeracionit dhe rregullat përkatëse për të gjitha lidhjet hyrëse dhe dalje për në/ose nga rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve publike.

3. Operatorët mund të përdorin numra të planit të numeracionit të vendeve të tjera në Republikën e Shqipërisë, nëse ata përdorin kodin ndërkombëtar të vendit respektiv dhe nëse përdorimi i këtyre numrave është në përputhje me rregulloret e vendit respektiv.

4. Operatorët mund të përdorin numra të planit shqiptar të numeracionit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëse përdorin kodin e vendit **“355”** dhe nëse përdorimi i këtyre numrave është në përputhje me rregulloret e vendit respektiv.

Neni 8

Numrat gjeografikë

1. Numrat gjeografikë janë percaktuar për t'u përdorur në një vendndodhje fikse, pra në rrjetet e qendrueshem(fiks) të komunikimeve publike. Një numër gjeografik përbehet nga kodi i destinacioni kombëtar (NDC) dhe numëri i pajtimtarit (SN).
2. Kodi kombëtar i destinacionit i korrespondon zonës gjeografike të vendndodhjes fikse. Shtojca 1 e kësaj rregulloreje specifikon se cili kod kombëtar destinacioni përdoret për secilën zonë gjeografike. Kodet kombëtare të destinacionit kanë një deri në tri shifra dhe fillojnë me **2, 3, 4, 5** ose **8**.
3. Numrat e pajtimtarëve kanë 5 deri në 7 shifra dhe fillojnë me çfarëdolloj shifre përveç shifrave **0** dhe **1**. Gjatësia e përgjithshme e një numri gjeografik (duke përfshirë kodin kombëtar të destinacionit dhe numrin e pajtimtarit) është 8 shifra.
4. AKEP, në procesin e alokimit paresor u cakton numra gjeografike operatorëve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve publike në blloqe prej 1.000 ose 10.000 numrash.
5. Operatorët, në procesin e alokimit dytesor caktojnë numra gjeografikë individualë për përdorim në një vendndodhje fikse. Një operator mund t'i caktojë një numër gjeografik një pajtimtari nëse:
 - a) numri gjeografik përdoret në një pikë fundore fikse të rrjetit, e cila ndodhet në një zonë gjeografike që i korrespondon kodit të destinacionit kombëtar të numrit gjeografik, ose
 - b) numri gjeografik përdoret në një zonë të vogël të rrjetit të komunikimeve të lëvizshme, e cila kufizon hapësirën rrethuese të një adresë që ndodhet në zonën gjeografike të ciles i korrespondon kodi i destinacionit kombëtar të numrit gjeografik (shërbimi i lëvizshëm-zona e shtëpisë-“home zone”);
 - c) operatori verifikon që adresa e pajtimtarit është brenda zonës gjeografike që i korrespondon kodit të destinacionit kombëtar të numrit gjeografik. Pajtimtari do të provojë adresën e tij duke i paraqitur operatorit një vërtetim të vendbanimit ose në rastin e një personi juridik dokumentin e regjistrimit (ekstraktin historik) të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
6. Operatorët, në procesin e alokimit dytesor mund të caktojnë numra individualë gjeografikë që janë më të shkurtër se ato të parashikuar në planin e numeracionit sipas kushteve të mëposhtme:
 - a) numrat gjeografikë mund të shkurtohen vetëm me një shifër, nëse pajtimtari përdor numrin për të lidhur të paktën pesë pajisje të përdoruesve fundorë sipas zgjatimeve të këtij numri.
 - b) Numrat gjeografikë mund të shkurtohen me dy shifra nëse pajtimtari përdor numrin për të lidhur të paktën 50 pajisje të përdoruesve fundorë sipas zgjatimeve të këtij numri.
 - c) Numrat gjeografikë mund të shkurtohen me tri shifra nëse pajtimtari përdor numrin për të lidhur të paktën 500 pajisje të përdoruesve fundorë sipas zgjatimeve të këtij numri.

7. Një numër gjeografik mund të përdoret përkohësisht në një vend jashtë zonës gjeografike që i korrespondon kodit të destinacionit kombëtar të numrit gjeografik (përdorimi nomadik). Operatorët që mundësojnë përdorimin nomadik, duhet të informojnë pajtimtarët për përfitimet dhe rreziqet e përdorimit nomadik, në vecanti në lidhje me shërbimet e thirrjeve të urgjencës. Në lidhje me tarifën e pakicës dhe interkoneksionit supozohet se një numër gjeografik përdoret kryesisht në vendndodhjen e vet fikse dhe që kostot shtesë të përdorimit nomadik paguhen nga pajtimtari dhe jo nga përdoruesi që thërret numrin gjeografik.

Neni 9 **Numrat e lëvizshëm**

1. Numrat e lëvizshëm janë percaktuar për t'u përdorur në një rrjet të lëvizshëm të komunikimeve publike. Një numër i lëvizshëm përbëhet nga prefiksi i numrave të lëvizshëm dhe një numër pajtimi.
2. Prefiksi i lëvizshëm ka dy ose tre shifra dhe fillon me **6**. Gjatësia e përgjithshme e numrave të lëvizshëm (prefiksi i numrave të lëvizshëm dhe numri i pajtimtarit) është nëntë shifra.
3. AKEP, në procesin e alokimit paresor (primary allocation), u cakton numra të lëvizshëm operatorëve të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike në blloqe prej 1.000 ose 10.000 numrash.
4. Operatorët, në procesin e alokimit dytesor (secondary allocation) u caktojnë numra individualë pajtimtarëve.
5. Për çdo operator të një rrjeti kombëtar të lëvizshëm të komunikimeve publike, AKEP do të rezervojë një prefiks të lëvizshëm dyshifror dhe do t'i caktojë serite numerike të këtij diapazoni numerik, vetëm këtij operatori. Për operatorë të tjerë të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve publike, AKEP do të rezervojë një prefiks të lëvizshëm me tri shifra. Operatorët nuk kanë nevojë të argumentojnë kërkesën e tyre kur aplikojnë për një bllok numrash brenda prefiksit dhe diapazonit të numrave që është rezervuar për ta.

Neni 10 **Numrat e urgjencës (112, 12X, ku X=5 ÷ 9)**

1. Numrat e urgjencës janë percaktuar për shërbimet që japin ndihmë të menjëhershme në situata urgjence.
2. Numrat e urgjencës kanë një gjatësi prej tri shifrash dhe fillojnë me shifren **1**. AKEP do të caktojë numrat e mëposhtëm të urgjencës:
 - a) numri i harmonizuar (HESC) i emergjencës **112** për të gjitha llojet e emergjencave;
 - b) numri **125** i lire
 - c) numri **126** për thirrjet ndaj policisë së trafikut;
 - ç) numri **127** për urgjencat mjekësore;
 - d) numri **128** për thirrjet ndaj zjarrëfikëses dhe
 - dh) numri **129** për të thirrur policinë e krimeve;

3. AKEP mund t'i caktojë të njëjtin numër urgjence institucioneve të ndryshme në zona të ndryshme. Të gjithë ofruesit e shërbimeve të urgjencës do të paraqesin informacionin e nevojshëm pranë AKEP për rrugëzimin në varësi të vendndodhjes së përdoruesit. AKEP do ta shpërndajë këtë informacion tek të gjithë operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve publike.
4. Ofruesit e shërbimeve të urgjencës duhet të garantojnë çdo ditë dhe gjatë gjithë kohës që thirrjet e shërbimeve të urgjencës të marrin përgjigjen dhe trajtimin e duhur.
5. Të gjithë operatorët e rrjeteve të telefonisë publike dhe shërbimeve të telefonisë publike duhet të garantojnë akses në shërbimet e urgjencës dhe duhet të rrugëzojnë thirrjet në varësi të vendndodhjes së përdoruesit të thirrur. Përdoruesit duhet të kenë mundësinë të thërrasin pa pagesë numrat e urgjencës nga çdo lloj telefoni, përfshirë këtu dhe telefonat publikë me pagesë, pa përdorimin e asnjë lloj pagese.

Neni 11

Numrat për shërbimet sociale të harmonizuara(116)

1. Numrat për shërbimet sociale të harmonizuara janë përcaktuar për përdorim për shërbimet sociale që janë të harmonizuara nga një vendim i Komisionit Europian.
2. Numrat për shërbimet sociale të harmonizuara kanë gjashtë shifra dhe fillojnë me **116**.
3. Për çdo numër për shërbimet sociale të harmonizuara, të harmonizuara nga një vendim i Komisionit Europian, AKEP do të publikojë një tender publik i cili përshkruan shërbimin respektiv dhe kriterin për cilësinë e shërbimit. Në vecanti AKEP do të specifikojë nëse shërbimi duhet të ofrohet çdo ditë dhe në çdo kohë.
4. Palët e interesuara do të paraqesin aplikimet në afatin e caktuar në tender, duke përfshirë dokumentacionin për masat organizative dhe teknike për të zbatuar shërbimin, numrin dhe kualifikimin e stafit dhe burimet buxhetore.
5. AKEP do t'i caktojë numrin përkatës aplikuesit që do të ofrojë shërbimin me cilësinë më të mirë. AKEP mund të përcaktojë një afat kohor për vlefshmërinë e vendimit të tij, mbas tejkalimit të cilit do të zhvillojë një tender të ri. AKEP mund të përshkruajë kriteret minimale për cilësinë e shërbimit në bazë të tenderit dhe aplikimit të paraqitur.
6. AKEP do të anulohet caktimin e numrit dhe do të zhvillojë një tender të ri, nëse nuk sigurohet shërbimi me cilësinë e kërkuar.

Neni 12

Numra për shërbimin e marrjes së informacionit (118)

1. Numrat për shërbimet e marrjes së informacionit janë përcaktuar për shërbimet që duhet të thirren nga përdoruesit për të marrë informacion për numrin e telefonit të pajtimtarëve të shërbimeve të telefonisë publike.
2. Në lidhje me tarifën me pakicë, për shërbimet e marrjes së informacionit zbatohen të njëjtat rregulla si dhe për shërbimet me vlerë të shtuar. Është e ndaluar të ofrohen shërbime të tjera me vlerë të shtuar përveç atyre për numërorin telefonik.
3. Numrat për shërbimin e informacionit kanë pesë shifra dhe fillojnë me 118.

4. AKEP cakton numra individualë për shërbimin e marrjes së informacionit për ofruesit e shërbimeve të marrjes së informacionit.

Neni 13

Kodet e shkurtër për shërbimet e operatorit (120 ÷ 124, 13Y, 14Y, 165, 189)

1. Kodet e shkurtër për shërbimet e operatorit janë percaktuar për shërbimet që janë të lidhura drejtpërdrejt me ofrimin e një shërbimi publik të telefonisë, si kujdesi për klientin, ndihma për klientin, hapja-mbyllja e kodit nga терминаlet jo MF, trajtimi i ankesave, pyetje për faturat, ngarkimi i kreditit të parapaguar, pyetje për kreditin e parapaguar ose pajtimi në shërbime/cilesi shtese.
2. Kodet e shkurtër për shërbimet e operatorit nuk mund të përdoren për të ofruar shërbime me vlerë të shtuar ose shërbime të tjera që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ofrimin e shërbimit të telefonisë publike. Tarifa me pakicë për thirrjen drejt një kodi të shkurtër për shërbimet e operatorit nuk duhet të jetë më e lartë se sa niveli më i lartë në tarifën përkatëse me pakicë të operatorit për thirrjen drejt numrave gjeografikë.
3. Kodet e shkurtër për shërbimet e operatorit kanë si qëllim vetëm përdorimin brenda rrjetit përkatës telefonik dhe nuk përdoren në interkoneksionin ndërmjet rrjeteve.
4. Kodet e shkurtër për shërbimet e operatorit kanë formatin me tri shifra
5. Të gjithë operatorët e rrjeteve të telefonisë publike ose të shërbimeve të telefonisë publike mund të përdorin kodin e shkurter **123** për mirëmbajtje pa kërkuar caktimin e këtij numri nga AKEP. Operatorët mund të shtojnë shifra shtesë pas **123** në varësi të vendndodhjes ose tipit të difektit.
6. Të gjithë operatorët e rrjeteve të telefonisë publike ose të shërbimeve të telefonisë publike mund të përdorin kodin e shkurter **189** për hapjen dhe mbylljen e kodit të pajtimtarit nga терминаlet jo-multifrekuence; konkretisht **1891** për hapjen dhe **1892** për mbylljen e kodit të pajtimtarit.
7. Të gjithë operatorët e rrjeteve ose të shërbimeve të telefonisë publike mund të përdorin kodin **165** për shërbimin “THIRRJE TELEFONIKE ME TARIFE TE REDUKTUAR PER PAJTIMTARE TE RRJETIT TE VET QE BEJNE PJESE NE GRUPE TE VEGJEL TE VEÇANTA TE TREGUT”.
8. Operatorët e rrjeteve të telefonisë publike ose të shërbimeve të telefonisë publike mund të përdorin kode të shkurtër në formatet **13Y** ose **14Y** pa kërkuar caktimin e këtyre numrave nga AKEP. Operatorët duhet të njoftojnë tek AKEP një listë të të gjithë kodeve të shkurtër dhe shërbimeve për të cilët janë përdorur këta kode të shkurtër.

Neni 14

Numrat personalë (700)

1. Numrat personalë janë krijuar për përdorim në cdo vendndodhje fikse ose për përdorim nomadik.
2. Në lidhje me tarifat me pakicë dhe të interkoneksionit, numrat personalë duhet të trajtohen si numra gjeografikë me përjashtimin që numri personal nuk përmban një kod kombëtar destinacioni që do të tregonte vendndodhjen e pajtimtarit. Tarifa me pakicë për thirrjet në numrat personalë nuk duhet të jetë më e lartë se sa niveli më i lartë në tarifën me pakicë të operatorit respektiv për thirrjet ndaj numrave gjeografikë.

3. Numrat personalë përbëhen nga prefiksi **700** dhe numri i pajtimtarit me pesë shifra. Gjatësia e përgjithshme e numrit është tetë shifra.
4. AKEP, ne procesin e alokimit paresor (primary allocation), u cakton numra personalë operatorëve të rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike në blloqe prej 1.000 ose 10.000 numrash.
5. Operatorët, ne procesin e alokimit dytesor (secondary allocation), caktojnë numra personalë individualë për pajtimtarët.

Neni 15 **Numrat Dial-up (717)**

1. Numrat Dial-up janë percaktuar për aksesin dial-up në internet ose shërbimeve të tjera të të dhënave nëpërmjet rrjetit telefonik publik.
2. Numrat Dial-up nuk mund të përdoren për shërbime të tjera përveç aksesit dial-up të internetit në vecanti jo për shërbimet me vlerë të shtuar.
3. Numrat Dial-up përbëhen nga prefiksi **717** dhe katër shifra.
4. AKEP u cakton numra individualë Dial-up ofruesve për akses dial-up në internet.
5. Ofruesit e shërbimeve të aksesit dial-up në internet duhet të informojnë pajtimtarët për pagesat që duhet t'i bëjnë operatorit të shërbimit të telefonisë dhe se cilat pagesa duhet t'i bëjnë ofruesit të shërbimit të aksesit dial-up.

Neni 16 **Numrat e gjelbër (800)**

1. Numrat e gjelbër janë percaktuar për shërbimet që mund të thirren pa pagesë.
2. Numrat e gjelbër përbëhen nga prefiksi **800** dhe një numër me katër shifra. Gjatësia e përgjithshme e një numri të gjelbër është shtatë shifra.
3. Tarifa me pakicës për thirrjet drjtuar numrave të gjelbër duhet të jetë zero.
4. AKEP cakton drejtpërdrejt numra të gjelbër për ofruesit shërbimeve të numrave të gjelbër.

Neni 17 **Numrat për kartat telefonike (801)**

1. Numrat për kartat telefonike janë percaktuar për thirrjen e drejt shërbimit të kartave telefonike.
2. Numrat për kartat telefonike nuk duhet të përdoren për shërbime të tjera përveç thirrjes në një kartë telefonike, në vecanti jo për shërbimet me vlerë të shtuar.
3. Numrat për kartat telefonike përbëhen nga prefiksi **801** dhe tre shifra.
4. AKEP cakton numra individualë për kartat telefonike për ofruesit e shërbimeve të kartave telefonike.
5. Ofruesit e shërbimeve të kartave telefonike duhet të informojnë pajtimtarët e tyre për pagesat që duhet t'i bëjnë operatorit të shërbimit telefonik, në vecanti, kur telefonohet nga një telefon publik me pagesë dhe cilat pagesa duhet t'i japin ofruesit të shërbimit të kartave telefonike. Ky

informacion duhet të përfshijë informacion për momentin kur fillon tarifimi dhe kur përfundon dhe në çfarë mase duhet paguar për telefonatat e pasuksesshme.

Neni 18 **Numrat blu (808)**

1. Numrat blu janë krijuar për shërbime që mund të thirren me tarifa të ulëta pakice.
2. Numrat blu përbëhen nga prefiksi **808** dhe një numër pajtimtari me tri shifra. Gjatësia e përgjithshme e një numri blu është gjashtë shifra.
4. AKEP cakton numrat blu individualë për ofruesit e shërbimeve të numrave blu.

Neni 19 **Numrat për shërbimet me vlerë të shtuar (900)**

1. Numrat për shërbimet me vlerë të shtuar janë caktuar për shërbimet, ku ofruesi i shërbimit merr një pjesë të pagesave me pakicë.
2. Numrat për shërbimet me vlerë të shtuar përbëhen nga prefiksi **900** dhe numri i pajtimtarit me tri shifra. Gjatësia e përgjithshme e një numri për shërbimet me vlerë të shtuar është gjashtë shifra.
3. AKEP cakton numra individualë për shërbimet me vlerë të shtuar për ofruesit e shërbimeve me vlerë të shtuar.

Neni 20 **Kodet e shkurtër për shërbimet SMS me vlerë të shtuar (5XXXX)**

1. Kodet e shkurtër për shërbimet SMS me vlerë të shtuar janë percaktuar për shërbimet me vlerë të shtuar në bazë të mesazheve tekst(SMS) ose mesazheve multimedialë (MMS), ku ofruesi i shërbimit merr një pjesë të tarifës me pakicës të paguar.
2. Kodet e shkurtër për shërbimet SMS me vlerë të shtuar kanë një gjatësi prej 5 shifrash dhe fillojnë me shifrën **5**.
3. Kodet e shkurtër për SMS me vlerë të shtuar nuk duhet të përdoren për shërbimet zanore.
4. AKEP cakton drejtpërdrejt kode të shkurtër individualë për shërbimet SMS me vlerë të shtuar për ofruesit e shërbimeve SMS me vlerë të shtuar.

Neni 21 **Kodet e shkurtër te harmonizuar europian (11X dhe 19X)**

1. Kodet e shkurter te harmonizuar europiane(HESCs) percaktohen per perdorim, per sherbime te harmonizuara ne rang europian, nga një vendim i Komisionit Europian.
2. AKEP miraton futjen ne Planin Kombetar te Numeracionit te cdo kodit te shkurter te harmonizuar europian(HESCs), te percaktuar per perdorim nga një vendim i Komisionit Europian.
3. Ne Planin Kombetar te Numeracionit per kodet e shkurter te harmonizuar europiane (HESCs) jane rezervuar serite numerike **11X** dhe **19X**.

Neni 22

Rregulla për shërbimet me vlerë të shtuar

1. Të gjithë operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve publike dhe ofruesit e shërbimeve me vlerë të shtuar duke përfshirë shërbimet SMS me vlerë të shtuar duhet të ndjekin rregullat e përcaktuara në këtë nen.
2. Ofruesit e shërbimeve me vlerë të shtuar, gjatë promovimit të shërbimeve të tyre duhet të japin një përshkrim të shërbimit dhe cmimin e tij në një mënyrë të duhur dhe lehtësisht të kuptueshme. Mashtrimi i përdoruesve duke dhënë informacion fals ose të gabuar ose duke fshehur informacion të rëndësishme, si cmimi i shërbimeve ose kufizime të shërbimit për shkak të moshës është i denueshem.
3. Numrat për shërbimet me vlerë të shtuar dhe kodet e shkurtër për shërbimet SMS nuk duhet të reklamohen nga thirrje apo mesazhe të pakërkua dhe nuk duhet të përdoren për identifikimin e linjës thirrëse. (CLI).
4. Cdo thirrje që bëhet ndaj shërbimit me vlerë të shtuar ose cdo mesazh i shkëmbyer me një shërbim SMS me vlerë të shtuar do të përfaqësojë një kontratë të vecantë ndërmjet përdoruesit thirrës dhe ofruesit të shërbimit me vlerë të shtuar në përputhje me dispozitat e Kodit Civil. Ofruesit e shërbimeve me vlerë të shtuar janë të detyruar të ndjekin rregulloret e vecanta për kontratat në distancë sipas dispozitave të Ligjit 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e Konsumatorëve, Pjesa V Kushtet e Padrejta të Kontratave dhe Përputhshmëria Kontraktuale.
5. Ofruesit e shërbimeve me vlerë të shtuar duhet të sigurojnë që cmimi për thirrjen e shërbimit me vlerë të shtuar njoftohet pa pagesë në fillim të cdo thirrjeje dhe që është i mundur përfundimi i thirrjes pas njoftimit brenda një periudhe kohe të arsyeshme para se të fillojë llogaritja e kohës së paguar. Ofruesit e shërbimeve me vlerë të shtuar SMS duhet të informojnë pa pagesë për cmimin e shërbimit para dhënies së shërbimit dhe mund ta japin shërbimin vetëm nëse përdoruesi ka konfirmuar këtë mesazh.
6. Ofruesit e shërbimeve me vlerë të shtuar do të ndërpresin automatikisht thirrjet drejt shërbimit me vlerë të shtuar pas një kohëzgjatjeje prej 15 minutash. Ofruesit e shërbimit SMS me vlerë të shtuar duhet të ofrojnë një mundësi për të ndaluar marrjen e shërbimit në cdo kohë, pa pagesë. Për cdo vlerë prej 500 leke të akumuluar për SMS të derguara ose të marra në mënyrë të vazhdueshme, për të përfituar shërbimin me vlerë të shtuar, ofruesi ka detyrimin të njoftojë përdoruesin pa pagesë për vlerën, dhe do të vazhdojë të ofrojë shërbimin vetëm nëse përdoruesi e konfirmon këtë mesazh.
7. Nëse një pajtimtar i paraqet një ankesë operatorit të një shërbimi telefonik publik në lidhje me shumën që ai duhet të paguajë për shërbimin e dhënë (SMS) me vlerë të shtuar ose në lidhje me sasinë që ai është i detyruar të paguajë për shërbimin e ofruar me vlerë të shtuar ose një ankesë në lidhje me cilësinë e shërbimit (SMS) me vlerë të shtuar të ofruar, operatori i shërbimit telefonik me vlerë të shtuar do të përdorë një prej dy metodave të shqyrtimit të ankesave:
 - a) Operatori i shërbimit me vlerë të shtuar shqyrtton të gjitha aspektet e ankesës duke përfshirë dhe ankesat për cilësinë ose përmbajtjen e shërbimit (SMS) të ofruar me vlerë të shtuar, të tilla si ankesa që ofruesi i shërbimit (SMS) me vlerë të shtuar nuk ka ofruar atë që deklarohet. Bashkëpunimi i nevojshëm ndërmjet operatorit të shërbimit telefonik publik dhe ofruesit të shërbimit (SMS) me vlerë të shtuar për shqyrtimin e të gjitha aspekteve të ankesës do të rregullohet në një kontratë mes operatorit dhe ofruesit.
 - b) Operatori i shërbimit telefonik publik nuk kërkon pagesën e shumës së diskutuar, lëshon një faturë të korregjuar dhe i dorëzon ankesën si dhe emrin dhe adresën e pajtimtarit dhe

detajet e thirrjeve të diskutuara (datën, kohën dhe kohëzgjatjen, numrin thirrës dhe numrin e thirrur) ofruesit të shërbimit (SMS) me vlerë të shtuar. Ofruesi i shërbimit (SMS) me vlerë të shtuar më pas duhet të lëshojë një faturë të vecantë për shërbimet e tij dhe duhet të shqyrtojë vetë të gjitha ankesat.

Neni 23

Plani i numërformimit

1. Të gjithë operatorët që mbështesin thirrjet drejt rrjetit telefonik publik duhet të përdorin prefiksin e thirrjeve ndërkombëtare **00** për thirrjet ndërkombëtare. Nëse një numër kombëtar është thirrur duke formuar prefiksin e thirrjes ndërkombëtare **00** dhe kodin kombëtar shqiptar **355** operatorët do ta trajtojnë numrin e thirrur njelloj sikur është thirrur prefiksi i thirrjes kombëtare **0** në vend të **00355**. Për thirrjet hyrëse ndërkombëtare numri kombëtar formohet menjëherë pas kodit kombëtar shqiptar **355**, pa formuar prefiksin kombëtar të thirrjes **0**.
2. Të gjitha thirrjet në rrjetin kombëtar duhet të përdorin prefiksin kombëtar të thirrjes **0** para numrit të plotë kombëtar. Përjashtimet e këtij rregulli përshkruhen në pikën 3 dhe 4 të këtij neni.
3. Për thirrjet nga një numër gjeografik tek një numër tjetër gjeografik, brenda të njëjtës zonë gjeografike, përdoruesi i numrit gjeografik mund të formojë:
 - a) vetëm numrin e pajtimtarit të palës së thirrur (thirrje lokale), ose
 - b) prefiksin kombëtar **0**, kodin e destinacionit kombëtar(NDC) dhe numrin e pajtimtarit të palës së thirrur(SN).

Të gjithë operatorët që mbështesin thirrjet nga numrat gjeografikë në numra të tjerë gjeografikë duhet t'u ofrojnë përdoruesve të tyre të dyja menyrat e thirrjes së numrave gjeografikë. Kjo dispozitë nuk parashikon formatin e përdorur për interkoneksion. Nëse përdoruesi formon një numër në një format që nuk e mbështet interkoneksionin, operatori duhet ta konvertojë në formatin e duhur para dërgimit në pikën e interkoneksionit.

4. Thirrjet drejt numrave të mëposhtëm që fillojnë me shifren **1** nuk përdorin prefiksin kombëtar (**0**): numrat e urgjencës (**112, 125, 126, 127, 128, 129**), numrat për shërbimet e harmonizuara të vlerës shoqërore (**116**), numrat për shërbimet për marrjen e informacionit (**118**) dhe të gjithë kodet e shkurter të harmonizuara europiane si dhe kodet e shkurtër për shërbimet e operatorit (**120-124, 13Y, 14Y, 165, 189Y**). Këto numra mund të thirren gjithashtu me prefiksin kombëtar **0** dhe kodin kombëtar të destinacionit(NDC) të një numri gjeografik. Në raste të tilla operatorët do të rrugëzojnë thirrjen sikur të origjinohej në një zonë gjeografike që i korrespondon kodit kombëtar të destinacionit(NDC).
5. Kodet e shkurtër për shërbimet (SMS) me vlerë të shtuar përdoren në rrjetet e lëvizshme pa prefiksin (**0**) ose një prefiks të levizshëm (**6X** ose **6XX**).
6. Përdoruesit e shërbimeve të zgjedhjes së bartësit thërrasin:
 - a) për thirrjet ndërkombëtare:

prefiksin e përzgjedhjes së bartësit (**10XX**), prefiksin e thirrjes ndërkombëtare (**00**) dhe numrin ndërkombëtar;
 - b) për thirrjet kombëtare (përvec thirrjeve lokale):

prefiksin për përzgjedhjen e bartësit (**10XX**), prefiksin e thirrjes kombëtare (**0**) dhe numrin e plotë kombëtar;

- c) për thirrjet lokale (sic referohet në pikën 3 të këtij neni):

prefiksin për përzgjedhjen e bartësit (**10XX**) dhe numrin e pajtimtarit(SN).

Të gjithë operatorët që mbështesin ose ofrojnë shërbimin e zgjedhjen ose parazgjedhjes së bartësit duhet të mbështesin këto metoda thirrjeje.

7. Operatorët nuk do të diferencojnë tarifën e tyre të pakicës në bazë të metodës së përodrur për formimin e një numri.

Neni 24

Prefiksi për zgjedhjen e bartësit (10XX)

1. Prefikset për zgjedhjen janë percaktuar për zgjedhjen e operatorit që do të faturojë thirrjen.
2. Prefikset për përzgjedhjen kanë katër shifra dhe fillojnë me shifren **10**.
2. AKEP cakton drejtpërsëdrejti prefikset individuale për zgjedhjen e bartësve për operatorët e shërbimeve telefonike publike të cilat kanë si qëllim të ofrojnë shërbime të zgjedhjes së bartësit në rrjetin telefonik publik të një operatori tjetër.

“Article 25

Kodet e rrugëzimit për portabilitetin e numrit (99XX)

1. Kodet e rrugëzimit për portabilitetin e numrit janë percaktuar për të ndihmuar rrugëzimin e thirrjeve ndërmjet operatorëve për sa i përket portabilitetit të numrit.
2. Kodet e rrugëzimit për portabilitetin e numrit kanë katër shifra dhe fillojnë me **99**.
3. AKEP cakton kodet individuale të rrugëzimit për portabilitetin e numrit për operatorët e shërbimeve të disponueshme për publikun.

Kapitulli III

Administrimi i numrit

Neni 26

Parimet

1. AKEP përpunon aplikimet sipas radhës që janë paraqitur. Kur AKEP hap një kategori të re numrash për herën e parë, ai publikon një afat për aplikimet e para. Të gjitha aplikimet që arrijnë para këtij afati trajtohen në mënyrë të barabartë dhe AKEP me anë të një shorti përcakton rradhën e përpunimit të aplikimeve.
2. AKEP cakton numrat në blloqe prej 1000 ose 10000 numrash ose si numra individualë, sic përshkruhen në kapitullin 2 për çdo kategori numrash.

3. Nëse rregullat e përcaktuara në kapitullin 2 lejojnë caktimin e numrave më të shkurtër apo më të gjatë, AKEP i mbështet vendimet e tij në kërkesën e përlogaritur për kategorinë përkatëse të numrave. Nëse është e mundur, AKEP fillimisht do të caktojë numra më të shkurtër dhe do të rezervojë pjesë të hapësirës së numeracionit të disponueshme për të caktuar numra më të gjatë nëse kërkesa do të rritet.
4. Aplikuesit mund të shprehin një preferencë për disa numra ose blloqe numrash të caktuar, por nuk kanë të drejtë që një numër ose blloqe të caktuara numrash t'u caktohen atyre.
5. Për çdo kategori numrash AKEP do të publikojë:
 - a) seritë e numrave që janë të gatshme për aplikime, dhe gjatësinë e numrave në serinë përkatëse të numrave;
 - b) seritë e numrave që janë rezervuar për aplikime në të ardhmen në rast të rritjes së kërkesës dhe
 - c) nëse AKEP do të marrë parasysh preferencat e aplikuesit për numra ose blloqe të caktuar, ose do t'i caktojë ato sipas radhës.

Neni 27 **Caktimi i numrave**

1. Këto rregullore përshkruajnë dy metoda për dhënien e së drejtës për të përdorur numra nga plani i numeracionit:
 - a) caktimin e drejtpërdrejtë:
AKEP cakton numra individualë për përdoruesit, ose
 - b) caktimin sipas procesit të alokimit paresor dhe dytesor:
AKEP cakton blloqe numrash në procesin e alokimit paresor (primary allocation) për operatorët e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve publike dhe këta operatorë caktojnë numra individualë në procesin e alokimit dytesor(second allocation) për pajtimtarët e tyre.
2. Numrat gjeografike, numrat e levizshëm dhe numrat personale caktohen sipas procesit të alokimit paresor dhe dytesor. Vetëm operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve mund të aplikojnë për numra që caktohen sipas procesit të alokimit paresor.
3. Numrat e urgjencës, numrat për shërbimet sociale të harmonizuara, numrat për shërbimet e informacionit, numrat Dial-up, numrat e gjelbër, numrat për kartat telefonike, numrat blu, numrat për shërbimet me vlerë të shtuar, kodet e shkurter për shërbimet SMS me vlerë të shtuar dhe kodet e shkurter të harmonizuar europiane(HESC) caktohen drejtpërdrejtë për ofruesit e këtyre shërbimeve. Nëse një shërbim i tillë ofrohet nepermjet bashkepunimit ndërmjet një operatori të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe një ofruesi(content provider), palet në bashkepunim do të vendosin se cili prej tyre do të mbajë përgjegjësinë për shërbimin e ofruar dhe do të aplikojë për caktimin e numrit.
4. Çdo përdorues, të cilit AKEP i ka caktuar drejtpërdrejtë një numer, është përgjegjës për të gjitha shërbimet e ofruara nepermjet këtij numri dhe çdo zgjatim të tij, vecanerisht për zbatimin e rregullave të vendosura nga Neni 22 i kësaj rregullore. Përdoruesi nuk mund të transferojë të drejtën për përdorimin e këtij numri(ose një zgjatim të tij) dhe përgjegjësinë për shërbimin e

ofruar nepermjet ketij numri ose cdo zgjatimi te tij tek nje perdorues tjeter, pervec menyres se pershkruar ne piken 5 te ketij neni.

5. Ne se perdorusi i nje numri te caktuar nga AKEP deshiron ta transferoje kete numer tek nje perdorues tjeter, te dy perdoruset duhet te aplikojne per kete transferim. AKEP do te anulloje caktimin e numrit per perdoruesin e pare do ta caktojete ate per perdoruesin e dyte, me kushtin qe perdoruesi i dyte te plotesoje kerkesat per caktimin e ketij numri. Operatoret e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve publike mund te ofrojne procedura te te ngjashme ne menyre qe te mbeshtesin transferimin e numrave te cilet jane caktuar sipas procesit te alokimit sekondar.
6. Procesi i portabilitetit te numrit nga operatori dhenes tek operatori marres rregullohet sipas nje rregulloreje te vecante per portabilitetin e numrit. Ne se pajtimtari i nje numri qe eshte caktuar sipas procesit te alokimit dytesor e bart kete numer, alokimi paresor i numrave te tjere ne bllokun respektiv mbetet i pandryshuar, por numri i bartur do te trajtohet sikur ai te kishte qene caktuar sipas procesit te alokimit paresor ne operatorin marres.

Neni 28

Aplikimi për caktimin e numrave

1. Aplikimi për caktimin e drejtpërdrejtë ose caktimin ne procesin e alokimit paresor mund të paraqitet nga operatorët e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve publike për kategorinë respektive të numrave sic përshkruhet në Kapitullin II të kësaj rregulloreje. Aplikimet mund të paraqiten me shkrim, nëpërmjet postës elektronike ose faksit, por vetëm ne adresën e AKEP, e-mail-in ose numrin e faksit të publikuar nga AKEP për qëllimin e administrimit të numrave. AKEP vendos për miratimin apo refuzimin e aplikimit brenda një periudhe 20 ditore.
2. Aplikimi do të përmbajë
 - a) emrin dhe adresën e aplikuesit;
 - b) dokumentet që provojnë regjistrimin e aktivitetit nëse aplikuesi nuk është subjekt i autorizimit të përgjithshëm sipas neneve 13 e vijues të ligjit 9918;
 - c) të dhënat për llojin, sasinë dhe qëllimin e përdorimit të numrave ose blloqeve të numrave për të cilët është aplikuar ;
 - ç) nevoja e përlogaritur për numra të së njëjtës kategorie (për numra gjeografikë: në të njëjtën zonë gjeografike) në tri vitet në vazhdim dhe përqindja e përdorimit të numrave të së njëjtës kategorie (ose të njëjtës zone gjeografike) që kanë qenë caktuar më parë.
 - d) data e planifikimit të fillimit të përdorimit të numrave ose të blloqeve të numrave për të cilat është bërë aplikimi.
 - dh) aplikimi mund të përmbajë një preferencë për caktimin e një numri të caktuar ose një bllok numrash.
3. Nëse aplikimi përmban të dhëna të pasakta ose të paplota, AKEP do t'i kërkojë aplikuesit të korrigjojë ose plotësojë të dhënat brenda 10 ditëve.
4. AKEP do të refuzojë caktimin e numrave ose blloqeve të numrave për të cilat është aplikuar, nëse:

- a) aplikimi përmban të dhëna të pasakta ose të paplota dhe këto nuk janë korrigjuar brenda afatit të caktuar sipas pikës 3 të këtij neni;
- b) aplikuesi nuk mund të përmbushë kriteret e përcaktuara në Kapitullin II të kësaj rregulloreje;
- c) qëllimi i përdorimit të numrave ose të blloqeve të numrave nuk është në përputhje me përdorimin e caktuar në Kapitullin II të kësaj rregulloreje;
- ç) sasia e kërkuar tejkalon nevojën e përlogaritur për numrat e kërkuar të kategorisë së kërkuar të numrave (për numrat gjeografikë: të zonës së kërkuar gjeografike), duke marrë parasysh përdorimin e numrave të caktuar aplikuesit dhe një rezervë operationale.

Në të gjitha rastet e tjera, AKEP do të caktojë numrat ose blloqet e numrave.

Neni 29

Anullimi i caktimit të numrave

1. AKEP do të anullojë caktimin e drejtpërdrejtë ose paresor të numrave ose blloqeve të numrave në rastet e mëposhtme:
 - a) Mbjtësi i numrit/numrave, nuk përdor numrat ose blloqet e numrave në përputhje me kërkesat e caktuara në rregullore ose në ligjin 9918.
 - b) Mbjtësi i numrit/numrave, nuk ka kryer pagesën vjetore për përdorimin e numrit ose blloqeve të numrave;
 - c) Mbjtësi i numrit/numrave, nuk ka filluar të përdorë numrat ose bllokun e numrave brenda një periudhe prej tri vitesh që nga data e caktimit.
2. Para se AKEP të anullojë caktimin e një numri ose blloku numerik, do të njoftojë mbajtësin e numrit, duke shpjeguar problemin dhe duke vendosur një afat prej jo më pak se 30 ditësh.
3. Kur AKEP vendos për anulimin e caktimit të një numri, do të dërgojë një njoftim të shkruar për mbajtësin e numrit. Afati i fillimit të zbatimit të këtij vendimi nuk mund të jetë më i shkurtër se 60 ditë që nga data e marrjes së njoftimit.
4. Mbjtësi i një numri mund të kerkojë të heqë dorë nga e drejta e përdorimit të numrave ose blloqeve të numrave duke dërguar një njoftim me shkrim në AKEP. AKEP do të konfirmojë marrjen e njoftimeve të tilla.
5. Nëse anulohet caktimi i një numri ose mbajtësi i një numri pengohet nga përdorimi i tij, AKEP do të rezervojë numrat ose blloqet e numrave të anuluar për një periudhë të përshtatshme kohe, në mënyrë që të evitohet që i njëjti numër të përdoret për shërbime të ndryshme ose nga pajtimtarë të ndryshëm në një periudhë të shkurtër kohore. AKEP nuk do t'i rezervojë numrat nëse kjo do të dëmtonte përdorimin e vazhdueshëm të të njëjtit shërbim apo nga të njëjtët pajtimtarë.

Neni 30

Vendimmarrja

1. Këshilli Drejtues i AKEP mund të delegojë kompetencën për të vendosur për caktimin e numrave dhe serive numerike. Në cdo rast Këshilli Drejtues shqyrton ankimmimet lidhur me procedurën e aplikimeve apo refuzimin e tyre.
3. Këshilli drejtues i AKEP vendos për caktimin e të gjitha kategorive të numrave ku vendimmarrja nuk është deleguar sipas pikës 1 të këtij neni. Gjithashtu Këshilli Drejtues vendos për anulimin e caktimit të numrave dhe serive numerike si dhe për të gjitha vendimet e referuara në këtë rregullore.

Neni 31

Statistikat për përdorimin e numrave

1. Të gjithë operatorët që mbajnë blloqe numrash gjeografikë, numra të lëvizshëm apo numra personalë do të informojnë AKEP-in se sa numra kanë caktuar ata në procesin e alokimit dytesor, në mënyrë të vecantë për cdo zonë numrash gjeografike, për cdo prefiks të lëvizshëm të rezervuar dhe për të gjithë kategorinë e numrave personalë. Ky informacion do të nxirret në fund të cdo viti dhe do dorëzohet në AKEP brenda datës 31 mars të vitit në vazhdim në një format elektronik sic specifikohet nga AKEP.

Neni 32

Publikimi

1. AKEP përditëson jo më rrallë se 1 herë në 3 muaj tabelat elektronike, të publikuara në faqen web, me të gjithë numrat dhe seritë numerike që ka caktuar apo rezervuar AKEP si dhe mundësitë për caktime të reja. Këto tabela do të përmbajnë blloqet e numrave dhe përdoruesit të cilëve ju janë caktuar aktualisht këto numra, sipas caktimit të drejtpërdrejtë të numrave individualë ose sipas procesit të alokimit paesor të serive numerike.
2. AKEP do të publikojë gjithashtu në faqen e internetit vendime për caktimin e numrave si dhe anulimin e caktimit të numrave, kur një vendim i tillë përmban informacion me interes të përgjithshëm që nuk mbulohet plotësisht nga tabelat e referuara në pikën 1 të këtij neni.

Kapitulli 4

Dispozita tranzitore dhe përfundimtare

Neni 33

Përputhshmëria me planin e numeracionit

1. Numrat që janë në përdorim në datën kur kjo rregullore hyn në fuqi, do të vazhdojnë të zbatohen deri më 12 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
2. Operatorët dhe ofruesit e shërbimit (SMS) duhet të implementojnë masat e përshkruara në nenin 22 të kësaj rregulloreje deri në gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
3. Operatorët që nuk mbështesin të gjitha metodat e formimit të numrave sic përshkruhet në nenin 23 të kësaj rregulloreje mund t'i zbatojnë këto metoda numërformimi deri më gjashtë muaj pasi kjo rregullore të hyjë në fuqi.
4. Të gjithë operatorët e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve publike kanë detyrimin të vlerësojnë nëse numrat e përdorur nga rrjetet ose shërbimet respektive dhe qëllimet për të

cilat janë përdorur këta numra janë në përputhje me rregullat e përcaktuara nga kjo rregullore. Operatorët duhet t'i dërgojnë AKEP-it një listë të të gjithë numrave jo të përputhshëm me kete rregullore (brenda tre muajve që nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje) dhe një përshkrim të masave të ndërmarra për të siguruar përputhjen me te (deri më tre muaj para se të përfundojë periudha tranzitore).

5. Të gjithë vendimet për caktime, vlefshmëria e të cilave është e lidhur me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, në rastet kur plotësohen kërkesat e kësaj rregulloreje, bëhen të vlefshme me afat të pa caktuar.
6. Kategoritë e numrave për numrat personalë (**700**), kode të shkurtër për shërbimet SMS me vlerë të shtuar (**5XXXXX**), prefikset për zgjedhjen e bartësit (**10XX**) dhe prefikset e rrugëzimit për portabilitetin e numrit (**99XX**) janë të hapur për aplikim të menjëhershëm dhe AKEP do të shqyrtojë të gjitha aplikimet që mbërrijnë (një muaj pasi të hyjë në fuqi kjo rregullore) në mënyrë të barabartë dhe të hedhë shorte në mënyrë që të përcaktohet se cili aplikim do të përpunohet i pari.

Neni 34 Shërbimet e urgjencës

1. Ofruesit e shërbimeve të urgjencës do të njoftojnë AKEP (tre muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje) për emrat dhe adresat e të gjithë personave juridikë ose organeve shtetërore që aktualisht ofrojnë shërbimet e urgjencës si dhe zonën gjeografike të mbuluar dhe informacionin e nevojshëm për rrugëzimin në varësi të vendndodhjes së personit që thërret.

Neni 35 Publikimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 shtator 2009.

Zonat gjeografike

Tabela e mëposhtme përcakton kodin e destinacionit për çdo çdo zone gjeografike:

KODI I DESTINACIONIT KOMBETAR (NDC)	RRETHI	BASHKITE BAZE BASHKITE E VOGLA Komunat
211	MALESIE MADHE	KOPLIK
212	PUKE	PUKE
213	TROPOJE	BAJRAM CURRI
214	HAS	KRUME
215	LEZHE	LEZHE
216	MIRDITE	RRESHEN
217	MAT	BURREL
218	DIBER	PESHKOPI
219	BULQIZE	BULQIZE
22	SHKODER	SHKODER
24	KUKES	KUKES
261	SHKODER	VAU-DEJES
262	SHKODER	Rrethinat, Ana-Malit
263	SHKODER	Pult, Shale, Shosh, Temal, Shllak
264	SHKODER	Postribe, Gur i Zi
265	SHKODER	Vig-Mnele, Hajmel
266	SHKODER	Bushat, Berdice
267	SHKODER	Dajç, Velipoje
268	MALESI E MADHE	Qender, Gruemire
269	MALESI E MADHE	Kastrat, Shkrel, Kelmend
270	KUKES	Kolsh, Surroj, Arren, Malzi
271	PUKE	FUSHE-ARREZ, Rrape
272	PUKE	Iballe, Fierze, Blerim, Qafe-Mali
273	PUKE	Qerret, Qelez, Gjegjan
274	TROPOJE	Tropoje, Llugaj, Margegaj
275	TROPOJE	Bujan, Fierze, Bytyc, Lekbibaj

KODI I DESTINACIONIT KOMBETAR (NDC)	RRETHI	BASHKITE BAZE BASHKITE E VOGLA Komunat
276	HAS	Fajza, Golaj, Gjinaj
277	KUKES	Shtiqen, Terthore, Zapod
278	KUKES	Bicaj, Topojan, Shishtavec
279	KUKES	Gryk-Çaje, Ujmisht, Bushtrice, Kalis
281	LEZHE	Shengjin, Balldre
282	LEZHE	Kallmet, Blinisht, Dajç, Ungrej
283	LEZHE	Kolsh, Zejmen, Shenkoll
284	MIRDITE	RUBIK
285	MIRDITE	Kthjelle, Selite
286	MIRDITE	Kacinar, Orosh, Fan
287	MAT	KLOS, Suc, Lis
288	MAT	Baz, Komsî, Gurre, Xiber
289	MAT	Ulez, Rukaj, Derjan, Macukull
291	DIBER	Tomin, Luzni
292	DIBER	Maqellare, Melan
293	DIBER	Kastriot, Muhur, Selishte
294	DIBER	Arras, Fushe-Çidhen, Lure
295	DIBER	Slllove, Zall-Dardhe, Zall-Rec, Kala e Dodes
296	BULQIZE	Fushe-Bulqize, Shupenze, Zerqan
297	BULQIZE	Gjorice, Ostren, Trebisht, Martanesh
311	KUÇOVE	KUÇOVE
312	SKRAPAR	ÇOROVODE
313	MALLAKASTER	BALLSH
32	BERAT	BERAT
33	VLORE	VLORE
34	FIER	FIER
35	LUSHNJE	LUSHNJE
360	SKRAPAR	Leshnje, Potom, Çepan, Gjerbes, Zhepe
361	BERAT	URA-VAJGURORE
362	BERAT	Velabisht, Roshnik
363	BERAT	Otlak, Lumas

KODI I DESTINACIONIT KOMBETAR (NDC)	RRETHI	BASHKITE BAZE BASHKITE E VOGLA Komunat
364	BERAT	Vertop, Terpan
365	BERAT	Sinje, Cukalat
66	BERAT	Poshnje, Kutalli
367	KUÇOVE	Perondi, Kozare
368	SKRAPAR	POLIÇAN, Bogove
369	SKRAPAR	Qender, Vendreshe
371	LUSHNJE	DIVJAKE
372	LUSHNJE	Karburnare, Fier-Shegan, Hysgjokaj, Ballagat
373	LUSHNJE	Krutje, Bubullime, Allkaj
374	LUSHNJE	Gradishte, Kolonje
375	LUSHNJE	Golem, Grabian, Remas
376	LUSHNJE	Dushk, Terbuf
377	MALLAKASTER	Qender, Greshice, Hekal
378	MALLAKASTER	Aranitas, Ngracan, Selite, Fratar, Kute
381	FIER	PATOS
382	FIER	ROSKOVEC
383	FIER	Qender
384	FIER	Mbrostar Ura, Llibofshe
385	FIER	Portez, Zharrez
386	FIER	Kuman, Kurjan, Strum, Ruzhdie
387	FIER	Cakran, Frakull
388	FIER	Levan
389	FIER	Dermenas, Topoje
391	VLORE	ORIKUM
392	VLORE	SELENICE
393	VLORE	HIMARE
394	VLORE	Qender
395	VLORE	Novosele
396	VLORE	Shushice, Armen
397	VLORE	Vllahine, Kote
398	VLORE	Sevaster, Brataj, Hore-Vranisht

KODI I DESTINACIONIT KOMBETAR (NDC)	RRETHI	BASHKITE BAZE BASHKITE E VOGLA Komunat
4	TIRANE	TIRANE
47	TIRANE	KAMEZ, VORE, Paskuqan, Zall-Herr, Burxulle, Preze
48	TIRANE	Kashar, Vaqar, Ndroq, Peze, Farke, Dajt
49	TIRANE	Petrelle, Baldushk, Berzhite, Krrabe, Shengjergj, Zall-Bastar
511	KRUJE	KRUJE
512	PEQIN	PEQIN
513	GRAMSH	GRAMSH
514	LIBRAZHD	LIBRAZHD
52	DURRES	DURRES
53	KURBIN	LAÇ
54	ELBASAN	ELBASAN
55	KAVAJE	KAVAJE
561	KURBIN	MAMURRAS
562	KURBIN	Milot, Fushe-Kuqe
563	KRUJE	FUSHE-KRUJE
564	KRUJE	Nikel, Bubq
565	KRUJE	Koder-Thumane, Cudhi
570	KAVAJE	Gose,Lekaj, Sinaballaj
571	DURRES	SHIJAK
572	DURRES	MANEZ
573	DURRES	SUKTH
574	DURRES	Rashbull, Gjepalaj
575	DURRES	Xhafzotaj, Maminas
576	DURRES	Katund i Ri, Ishem
577	KAVAJE	RROGOZHINE
578	KAVAJE	Synej, Golem
579	KAVAJE	Luz i Vogel, Helmes,Kryevidh
580	PEQIN	Perparim, Pajove
581	ELBASAN	CERRIK
582	ELBASAN	BELSH

KODI I DESTINACIONIT KOMBETAR (NDC)	RRETHI	BASHKITE BAZE BASHKITE E VOGLA Komunat
583	ELBASAN	Bradashesh, Shirgjan
584	ELBASAN	Labinot-Fushe, Labinot-Mal, Funare, Gracen
585	ELBASAN	Shushice, Tregan, Gjinar, Zavaline
586	ELBASAN	Gjergjan, Paper, Shales
587	ELBASAN	Gostime, Klos, Mollas
588	ELBASAN	Rrase, Fierze, Kajan, Grekan
589	PEQIN	Karine, Gjocaj, Sheze
591	LIBRAZHD	Prrenjas
592	LIBRAZHD	Qender
593	LIBRAZHD	Lunik, Orenje, Stebleve
594	LIBRAZHD	Hotolisht, Polis, Stravaj
595	LIBRAZHD	Qukes, Rajce
596	GRAMSH	Pishaj, Sult, Tunje, Kushove, Skenderbegas
597	GRAMSH	Kodovjat, Poroçan, Kukur, Lenic
811	DEVOLL	BILISHT
812	KOLONJE	ERSEKE
813	PERMET	PERMET
814	TEPELENE	TEPELENE
815	DELVINE	DELVINE
82	KORÇE	KORÇE
83	POGRADEC	POGRADEC
84	GJIROKASTER	GJIROKASTER
85	SARANDE	SARANDE
860	POGRADEC	Trebinje, Proptisht, Velçan
861	KORÇE	MALIQ
862	KORÇE	Qender
863	KORÇE	Drenove, Mollaj
864	KORÇE	Voskop, Voskopoje, Vithkuq, Lekas
865	KORÇE	Gore, Pirc, Moglice
866	KORÇE	Libonik, Vreshtaz
867	KORÇE	Pojan, Liqenas

KODI I DESTINACIONIT KOMBETAR (NDC)	RRETHI	BASHKITE BAZE BASHKITE E VOGLA Komunat
868	POGRADEC	Buçimas, Udenisht
869	POGRADEC	Çerave, Dardhas
871	KOLONJE	LESKOVIK, Leskovik, Barmash, Novosele
872	KOLONJE	Qender Erseke, Mollas, Çlirim
873	DEVOLL	Qender Bilisht, Proger
874	DEVOLL	Hoçisht, Miras
875	PERMET	KELCYRE
876	PERMET	Qender, Frasher, Petran, Çarshove
877	PERMET	Dishnice, Suke, Ballaban
881	GJIROKASTER	LIBOHOVE, Qender
882	GJIROKASTER	Cepo, Picar, Lazarat, Atigon
883	GJIROKASTER	Lunxheri, Odrie, Zagorie, Pogon
884	GJIROKASTER	Dropull i Poshtem, Dropull i Siperm
885	TEPELENE	MEMALIAJ, Memaliaj Fshat
886	TEPELENE	Qender, Kurvelesh, Lopez
887	TEPELENE	Qesarat, Krahes, Luftinje, Buz
891	SARANDE	KONISPOL, Xare, Markat
892	SARANDE	Aliko, Lukove
893	SARANDE	Ksamil
894	SARANDE	Livadhja, Dhiver
895	DELVINE	Finiq, Mesopotam, Vergo

NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR.10, PËR “CAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E
NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE” TË MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT
DREJTUES TË AKEP NR. 932 DATË 11.08.2009,

Miratuar me VKD nr. 2394, date 05. 12. 2013.

Neni 1

Ne pikën 1 të nenit 1 “Objekti” në fund të fjalisë ekzistuese, shtohet paragrafi:

“i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 2

1. Pika 2 e nenit 3 “Përkufizime”, ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

2. “Identifikimi i linjës thirrëse” është funksioni që, në bazë të numrit ose kodit të caktuar për pikën fundore të rrjetit, i mundëson pajtimtarit marrës të thirrjes të identifikojë pikën fundore të rrjetit, ku është origjinuar thirrja.

2. Pika 5 e nenit 3 ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

5. “Kodi Kombëtar i Drejtimit”(National Destination Code-NDC) është një numër apo një kombinim numrash pa prefiksin kombëtar “0”, i cili karakterizon zonën e numeracionit të thirrur. Nëse plani kombëtar i numeracionit është “i hapur” dhe kur pajtimtari thirrës dhe ai i thirrur u përkasin zonave të ndryshme të numeracionit, ky kod formohet përpara numrit të pajtimtarit të thirrur. Për rrjetet e lëvizëshme të komunikimeve publike në këtë rast përdoret termi “Kodi i Drejtimit të Rrjetit”.

3. Pika 16 e nenit 3 ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

16. “Rrjet i komunikimeve elektronike” janë sistemet e transmetimit dhe, nëse ekzistojnë, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, përfshirë elementet e rrjetit që nuk janë aktive, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse tokësore (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin), rrjetet e lëvizshme tokësore, sistemet e kablllove elektrike, në raste kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e

përdorura për transmetimet radiotelevizive dhe rrjetet kabllore televizive, pavarësisht nga tipi i informacionit të përcjellë.

4. Pika 17 e nenit 3 formulohet si vijon:

17. “Rrjet i komunikimeve publike” është një rrjet i komunikimeve elektronike, që përdoret, tërësisht ose kryesisht, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun dhe që suporton transferimin e informacionit ndërmjet pikave fundore të rrjetit.

5. Pika 22 e nenit 3 “Përkufizime” shfuqizohet.

6. Pika 24 e nenit 3 “Përkufizime” ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

24. “Shërbim telefonik i disponueshëm për publikun” është një shërbim i disponueshëm për publikun për origjinimin dhe marrjen direkte ose indirekte të thirrjeve kombëtare, apo kombëtare e ndërkombëtare, nëpërmjet një ose më shumë numrave në një plan numeracioni telefonik kombëtar ose ndërkombëtar”.

Neni 3

Pika 5 e nenit 9 ” Numrat e lëvizshëm”, ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

5. Për çdo operator të një rrjeti kombëtar të lëvizshëm të komunikimeve publike, AKEP do të rezervojë një *kod te drejtimit* të rrjetit të lëvizshëm dyshifror dhe do t’i caktojë serite numerike të këtij diapazoni numerik, vetëm këtij operatori. Për operatorë të tjerë të rrjeteve ose shërbimeve të lëvizshme të komunikimeve publike, AKEP do të rezervojë një *kod të drejtimit* të rrjetit të lëvizshëm me tri shifra. Operatorët nuk kanë nevojë të argumentojnë kërkesën e tyre kur aplikojnë për një bllok numrash brenda *kodit të drejtimit të rrjetit* të lëvizshëm dhe diapazonit të numrave që është rezervuar për ta.”

Neni 4

Neni 11 ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

Neni 11

Numrat për shërbimet sociale te harmonizuara (116)

1. Numrat për shërbimet sociale të harmonizuara janë percaktuar për përdorim, në përputhje me vendimet e Komisionit European për këtë qëllim.
2. Numrat për shërbimet sociale te harmonizuara kanë gjashtë shifra dhe fillojnë me 116.

3. Duke qenë se numrat për shërbimet sociale të harmonizuara janë të kufizuar, e drejta e caktimit dhe përdorimit të tyre do të jepet aplikuesit që e ka fituar këtë të drejtë mbi bazën e legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.
4. Numri për shërbimet sociale të harmonizuara mund të jepet edhe për përdorim të përbashkët.
5. AKEP do t'i caktojë numrin përkatës aplikuesit të vlerësuar si fitues sipas pikës 3 të mësipërme.
6. AKEP përcakton një afat kohor sipas ligjit për komunikimet elektronike, për vlefshmërinë e të drejtës së përdorimit nga aplikanti të numrit për shërbimet sociale të harmonizuara.
7. AKEP mund të përshkruajë kriteret minimale për cilësinë e shërbimit në bazë të njoftimit dhe aplikimit të paraqitur.
8. AKEP do të anullojë caktimin e numrit dhe do të zhvillojë një procedurë të re, nëse nuk sigurohet përdorimi i tij sipas qëllimit të dhënë dhe ofrimi i shërbimit me cilësinë e kërkuar.

Neni 5

Të bëhen këto ndryshime sipas neneve më poshtë:

1. Në nenin 3 pika 24/ç fjalët "të këtij ligji" zëvendësohen me fjalët "të kësaj rregullore".
2. Në nenin 5 pika 2, pas fjalëve "ligjit 9918" shtohet fjala "i ndryshuar".
3. Në nenin 6 pika 2/ç, fjala "kodet" zëvendësohen me fjalën "prefikset".
4. Në nenin 9 pika 2, fjalët "Prefiks i lëvizshëm" zëvendësohen me fjalët "Kodi i Drejtimit të Rrjetit".
5. Në nenin 10 pika 2/b, fjala "i lirë" zëvendësohen me fjalët "për thirrjet ndaj QNOD-emergjencat në det".
6. Në nenin 25 fjala "Article" me fjalën "Neni"
7. Në pikën 3 e Nenit 26 "kapitulli 2" me " kapitulli II".
8. Në pikën 5 e Nenit 27 hiqet një "të" aty ku janë dy "të të".
9. Në nenet 13, 20 fjalët "kod/et" (kudo janë) zëvendësohen me fjalët "numër/at"
10. Në nenet 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19 termi "prefiks" zëvendësohet me termin "kod aksesit".
11. Në nenin 23 pika 5 fjalët "një prefiks të lëvizshëm" zëvendësohen me fjalët "kod të drejtimit të rrjetit".
12. Në nenin 27 pika 1 fjala "rregullore" zëvendësohet me fjalën "rregulla".
13. Në nenin 28 pika 2 b), pas fjalës "ligjit 9918" shtohet fjala "i ndryshuar".
14. Në nenin 29 pika 1 a), pas fjalës "ligjin 9918" shtohet fjala "i ndryshuar".

Neni 6

Pika 1 e nenit 28 “Objekti”, ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

1. Aplikimi për caktimin e drejtpërdrejtë ose caktimin në procesin e alokimit parësor për kategorinë respektive të numrave, sikurse përshkruhet në Kapitullin II të kësaj rregulloreje, do të paraqitet nga operatorët e rrjeteve ose shërbimeve të komunikimeve publike. Aplikimet mund të paraqiten me shkrim, nëpërmjet aplikimit online, nëpërmjet postës elektronike ose faksit, por vetëm në adresën e AKEP, e-mail-in ose numrin e faksit të publikuar nga AKEP për qëllimin e administrimit të numrave. AKEP-i vendos për këto aplikime brenda jo më shumë se tri javëve.
Sqarim: Fjalja e fundit është sipas fjalise së dytë të pikës 1 të nenit 82, të ligjit 9918, i ndryshuar.

Neni 7

Në nenin 29 “Anullimi i caktimit të numrave”, në pikën 1 fjalja:

“AKEP do të anullovë caktimin e drejtpërdrejtë ose parësor të numrave ose blloqeve të numrave në rastet e mëposhtme:”

zëvendësohet me fjalinë:

“AKEP me vendim të Këshillit Drejtues anullov caktimin e drejtpërdrejtë ose parësor të numrave ose blloqeve të numrave në rastet e mëposhtme:”

Neni 8

Neni 30 “Vendimmarrja”, formulohet si më poshtë:

Neni 30 Miratimi

1. Këshilli Drejtues i AKEP miraton:
 - a. planin kombëtar të numeracionit.
 - b. kodin e drejtimit të rrjetit(NDC) për çdo operator të një rrjeti të lëvizshëm të komunikimeve publike.
 - c. kodin kombëtar të destinacionit(NDC) për një zonë gjeografike të vendndodhjes fikse ose ndryshime të tij.
 - ç. hapjen e një kategorie të re numrash.
2. Kategoritë e numrave dhe serive numerike që nuk përfshihen në pikën 1 të këtij neni, caktohen nga AKEP sipas procedurës së përcaktuar në këtë rregullore mbi bazën e dokumentacionit të përgatitur nga strukturat përgjegjëse të AKEP.

Neni 9

Pas Nenit 30, shtohet neni 30/1 “Ankimimi”, me përmbajtjen si më poshtë:

Neni 30/1
Ankimimi

Këshilli Drejtues i AKEP sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, shqyrton ankimimet lidhur me procedurën e aplikimeve apo refuzimin për caktimin e numrave apo serive numerike.

Neni 10

Shtojca 2, Forma e Aplikimit për caktimin e numrave, në Rregulloren për Caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit miratuar me vendim të Këshillit Drejtues Nr. 932, datë 11.08.2009, pas ndryshimeve formulohet sipas Shtojcës-2/1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 11

Ndryshimet e kësaj rregulloreje hyjnë në fuqi më 01.01.2014 dhe publikohen në faqen e Internetit të AKEP.



A K E P

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

FORMULAR APLIKIMI PER CAKTIMIN E NUMRAVE

Dokument N°: _____

Data: / /

**A K E P**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Shenime/Deklarate

1. Bazuar në Ligjin Nr 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar, Neni 82, Sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike aplikojnë në AKEP për caktimin e numrave dhe serive numerike.
2. Sipërmarrësit kanë të drejtë të caktojnë numra apo seri numerike për përdoruesit e tyre fundore, brenda numeracionit të caktuar nga AKEP.
3. Mbatjsi i të drejtës së përdorimit të numrave të caktuar nga AKEP duhet të zbatohet kushtet për përdorimin e numrave në përputhje me Nenin 83 të Ligjit Nr 9918, datë 19.05.2008 i ndryshuar,
4. Ndryshimi dhe anulimi i vendimeve të AKEP për caktimin e numrave dhe serive numerike bëhet në përputhje me Ligjin Nr 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar, respektivisht Neni 84 dhe Neni 85.

Formulari dërgohet në Adresën:

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - AKEP

Rr. "Reshit Çollaku", No. 43
Kutia Postare: 253/1
Tiranë / Albania

Ose plotësohet online në sitin web, www.aplikimeonline.al ose www.akep.al.



FORMULARI I APLIKIMIT PER CAKTIMIN E NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
Adresa Postare		Data e Regjistrimit ne QKR
		/ /
Qyteti / Shteti		Kutia Postare
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit (Drejtuesi Teknik)		
Telefon	Fax	E-mail

- Unë/ne operojmë me një rrjet publik të telefonisë fikse ose një shërbim publik të telefonisë fikse dhe aplikoj për seri **numrash gjeografikë** në zonat e mëposhtme gjeografike:

Zona gjeografike		Kodi Kombetar i Drejtimit NDC	Aplikimi per		Nevoja e llogaritur për numra në këtë zone për tri vitet e ardhshme	Sasia e numrave te caktuar tashmë në këtë zonë?	Përqindja e përdorimit të numrave të caktuar në këtë zonë?
BASHKIA	Komuna		Bllloqe 1,000 numrash	Bllloqe 10,000 numrash			



- Unë/ne operojmë me një rrjet ose shërbim publik të telefonisë së lëvizshme dhe aplikojmë për serite në vazhdim të **numrave te levizshem** :

Kodi i Drejtimit të Rrjetit (NDC)	Treguesi i adreses së regjistrimit të vendndodhjes (HLR)		Diapazoni i Numrit të Pajtimtarit (SN)		
	h ₁	h ₂	Fillimi i numeracionit	Fundi i numeracionit	Bloqe numerike 10.000 numrash Gjithsej

- Unë/ne synojmë të ofrojmë një **shërbim informacioni** dhe të aplikojmë për numrin **1 1 8** __ (preferohet), **1 1 8** __ (alternative e parë) ose **1 1 8** __ (alternative e dytë).

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____

Për ofruesit të cilëve u është caktuar një numër për shërbimet e informacionit:

Shto një shpjegim të detajuar se përse keni nevojë për një numër të ri.

- Unë/ne operojmë me një rrjet ose shërbim publik të telefonisë dhe aplikojmë për seri numrash të **numrave personalë**:

Aplikimi për blloqe 1000 numra: _____

Blloqet e preferuara të numrave (psh. **700** 11XXX):

Nevoja e përllogaritur për numra personalë në tri vitet në vazhdim: _____

Sa numra personalë janë caktuar tashmë: _____

Përqindja e përdorimit të numrave të caktuar: _____%



- Unë/ne synojmë që të ofrojmë një shërbim të **numrave të gjelbër** dhe aplikojmë për numrat e mëposhtëm:

Aplikimi për sa numra individualë: _____

Numrat e preferuar (psh. **800** 1234):

Nevoja e përllogaritur për numra të gjelbër në tri vitet në vazhdim: _____

Sa numra të gjelbër janë caktuar tashmë: _____

Përqindja e përdorimit të numrave të caktuar : _____%

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____

- Unë/ne synojmë të ofrojmë një shërbim të **kartave telefonike** dhe aplikojmë për numrat e mëposhtëm:

Aplikimi për sa numra individualë: _____

Numrat e preferuar (e.g. **801** 123):

Data e fillimit të shërbimit: _____

- Unë/ne synojmë të ofrojmë një shërbim të **numrave blu** dhe aplikojmë për numrat e mëposhtëm:

Aplikimi për sa numra individualë: _____

Numrat e preferuar (e.g. **808** 123):

Nevoja e përllogaritur për numrat blu në tri vitet në vazhdim: _____

Sa numra blu janë caktuar tashmë: _____

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____

- Unë/ne synojmë të ofrojmë një **shërbim Dial-up** dhe aplikojmë për numrat në vazhdim:

Aplikimi për sa numra individualë: _____

Numrat e preferuar (e.g. **717** 123): _____

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____



- Unë/ne synojmë të ofrojmë **një shërbim me vlerë të shtuar** dhe aplikojmë për numrat në vazhdim:

Aplikimi për sa numra individualë: _____

Numrat e preferuar (e.g. **900** 123):

Nevoja e përllogaritur për shërbim me vlerë të shtuar në tri vitet në vazhdim: _____

Sa numra për shërbimin me vlerë të shtuar janë caktuar tashmë: _____

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____

- Unë/ne synojmë të ofrojmë **një shërbim SMS/MMS me vlerë të shtuar** dhe aplikojmë për numrat e shkurtër si më poshtë:

Aplikimi për sa kode individuale të shkurtër: _____

Numrat e preferuar (e.g. **51234**):

Nevoja e përllogaritur për kode të shkurtër për shërbimet SMS me vlerë të shtuar në tri vitet në vazhdim: _____

Sa kode të shkurtër për shërbimet SMS me vlerë të shtuar janë caktuar: _____

Përqindja e përdorimit të kodeve të shkurtër: _____%

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____

- Unë/ne operojmë me një rrjet ose shërbim telefonik publik dhe synojmë të ofrojmë **shërbime të përzgjedhjes së bartësit**. Unë/ne aplikojmë për prefiksin e zgjedhjes së bartësit **1 0** __ (I preferuar), **1 0** __ (alternative e parë) or **1 0** __ (alternative e dytë).

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____

Për operatorët që u është caktuar tashmë një kod i përzgjedhjes së bartësit:

Shto një shpjegim të detajuar se përse keni nevojë për një kod tjetër.



- Unë/ne operojmë me një rrjet ose shërbim telefonik publik dhe kemi nevojë për **prefiksin e rrugëzimit për portabilitetin e numrit**. Unë/ne aplikojmë për prefiksin e rrugëzimit për portabilitetin e numrit **99** __ (I preferuar), **99** __ (alternative e parë) ose **99** __ (alternative e dytë).

Data e planifikuar e fillimit të shërbimit: _____

Për operatorët që u është caktuar tashmë një prefiksin e rrugëzimit për portabilitetin e numrit:

Shto një shpjegim të detajuar se përse keni nevojë për një kod tjetër.

Data: _____ / / _____

Nënshkrimi dhe Vula

Vendi: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

NJOFTIM

NR. ____, DATË __.__.__

“PER CAKTIM DHE PËRDORIM NUMERACIONI”

**OPERATORIT TE RRJETEVE DHE/OSE SHERBIMEVE TE
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE / SUBJEKTIT:**

” _____ ” SH.P.K/SH.A

KRYETARI



ANEKSI 1

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM SERI NUMRASH GJEOGRAFIKË

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
Adresa Postare		Data e Regjistrimit ne QKR
		/ /
Qyteti / Shteti		Kutia Postare
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit		
Telefon	Fax	E-mail

Rrethi : _____

Nr.	Zona Gjeografike		NDC	Diapazoni i SN		Kapaciteti i alokuar i SN	Konfigurimi i NSN (NDC + SN) *
	Bashkia	Komuna		Fillimi	Mbarimi		
1.							
2.							
3.							
4.							
5.							
6.							

Ku: Formati i Numrit Sinjifikativ Kombëtar (NSN) është me 8-shifra, dhe ka konfigurimin e treguar në kolonë (X YYYYYYYY ose XX YYYYYY ose XXX YYYYY), ku shenjat X tregojnë sasinë e shifrave që formojnë NDC (Kodin Kombëtar të Drejtimit - *National Destination Code*) dhe shenjat Y tregojnë sasinë e shifrave që formojnë SN (Numrin e Pajtimtarit - *Subscriber Number*).

Formati i numrit për të realizuar thirrje :

- Kombëtare brenda Zonës/Rajonit të Numeracionit - **NDC+SN [NSN]**
- Kombëtare jashtë Rajonit të Numeracionit - **0 + NDC + SN [0 + NSN]**
- Ndërkombëtare: - **00 + CC + NSN**
[ku : CC-Kodi i Vendit]

K R Y E T A R I



ANEKSI 2

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM SERI NUMRASH TË LËVIZSHËM

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
Adresa Postare		Data e Regjistrimit ne QKR
		/ /
Qyteti / Shteti		Kutia Postare
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit		
Telefon	Fax	E-mail

Nr.	Kodi i Drejtimit të Rrjetit (NDC)	Treguesi i Adreses së Regjistrimit të Vendndodhjes (HLR)		Diapazoni i Numrave të Pajtimtarëve (SN)		Gjithsej blloqe 10.000 numrash
		h1	h2	Fillimi	Fundi	
1.						
2.						
3.						

KRYETARI



ANEKSI 3

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM NUMERACIONI

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
Adresa Postare		Data e Regjistrimit ne QKR
		/ /
Qyteti / Shteti		Kutia Postare
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit		
Telefon	Fax	E-mail

Në kategorinë e shërbimeve me vlerë të shtuar (Ndarje të Ardhurash) të Planit Kombëtar të Numeracionit, caktohet për përdorim kodi i shkurtër:

(0) 900 Y₁Y₂Y₃ Zabc....

ku:

- 0 - prefiksi kombëtar;
- 900 - identifikon Kodin e Aksesit të harmonizuar në nivelin kombëtar për grupet e shërbimeve;
- Y₁Y₂Y₃ - është numri i shkurtër që identifikon subjektin e autorizuar për ofrimin e shërbimit;
- Z - përfaqëson nivelet tarifore (Z=1 përfaqëson nivelet tarifore më të ulët, Z=6 përfaqëson nivelin tarifor më të lartë, Z=7 deri Z=0 përfaqësojnë nivele tarifore për shërbime të veçanta);
- abc... - shifra nga 1 deri në 0 për shërbimet brenda nivelit tarifor.

K R Y E T A R I



ANEKSI 4

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM NUMERACIONI

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
Adresa Postare		Data e Regjistrimit ne QKR
		/ /
Qyteti / Shteti		Kutia Postare
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit		
Telefon	Fax	E-mail

Në kategorinë e shërbimeve me vlerë të shtuar (Ndarje të Kostos) të Planit Kombëtar të Numeracionit, caktohet për përdorim kodi i shkurtër:

(0) **808 Y₁Y₂Y₃**

ku:

- 0 - prefiksi kombëtar;
- 808 - identifikon Kodin e Aksesit të kategorise së shërbimit me ndarje të kostos, i harmonizuar në nivel kombëtar;
- Y₁Y₂Y₃ - është numri identifikues i sipërmarrësit që ofron shërbimin.

KRYETARI



ANEKSI 5

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM NUMERACIONI

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
Adresa Postare		Data e Regjistrimit ne QKR
		/ /
Qyteti / Shteti		Kutia Postare
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit		
Telefon	Fax	E-mail

Në kategorinë e shërbimit Thirrje me Karte (Calling Card) te Planit Kombëtar të Numeracionit, caktohet për përdorim kodi i shkurtër:

(0) **801 Y₁Y₂Y₃**

ku:

- 0 - prefiksi kombëtar;
- 801 - identifikon Kodin e Aksesit të kategorisë së shërbimit Thirrje me Kartë i harmonizuar në nivel kombëtar;
- Y₁Y₂Y₃ - është numri identifikues i sipermarresit që ofron shërbimin.

KRYETARI



ANEKSI 6

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM NUMERACIONI

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
Adresa Postare		Data e Regjistrimit ne QKR
		/ /
Qyteti / Shteti		Kutia Postare
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit		
Telefon	Fax	E-mail

Në kategorinë e shërbimit SMS me Vlerë të Shtuar (SMS-VAS) të Planit Kombëtar të Numeracionit, caktohet për përdorim numri i shkurtër:

5XXXX

Kodi i shkurtër për Shërbimin me Vlerë të Shtuar nuk duhet të përdoren për shërbime zanore.

K R Y E T A R I



ANEKSI 7

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM NUMERACIONI

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
Adresa Postare		Data e Regjistrimit ne QKR
		/ /
Qyteti / Shteti		Kutia Postare
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit		
Telefon	Fax	E-mail

Në kategorinë e shërbimit të numrave të gjelbër- (Telefona pa pagese) të Planit Kombëtar të Numeracionit, caktohet për përdorim kod i shkurtër:

(0) 800 Y₁Y₂Y₃Y₄

ku :

- 0 -prefiksi kombëtar;
- 800 -identifikon Kodin e Aksesit të kategorisë së shërbimit të numrave të gjelbër (Telefona pa Pagese), i harmonizuar në nivel kombëtar;
- Y₁Y₂Y₃Y₄ -identifikon përdoruesin.

Ky kod i shkurtër duhet të jetë :

- **njedrejtimesh:** nga përdoruesit (pavaresisht operatorit), në drejtim të Subjektit;
- **i hapur:** i mundshëm për tu thirrur si nga telefonat të cilët nëpërmjet kodit individual të përdoruesit, janë të mbyllur për thirrje kombëtare/ndërkombëtare, ashtu edhe nga telefonat publikë;
- **i pakushtezuar:** thirrjet drejt këtij kodit të shkurtër, pavarësisht rrjetit të komunikimeve publike apo vend-ndodhjes gjeografike brenda vendit prej ku gjenerohet thirrja, të realizohen vetëm nëpërmjet numërformimit “0 800 Y₁Y₂Y₃Y₄”;
- **pa pagese:** thirrjet drejt këtij kodit të shkurter, pavarësisht rrjetit të komunikimeve publike apo vend-ndodhjes gjeografike brenda vendit prej ku gjenerohet thirrja, të realizohen pa pagesë për përdoruesin “thirrës”.

KRYETARI



ANEKSI 8

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM NUMERACIONI

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
Adresa Postare		Data e Regjistrimit ne QKR
		/ /
Qyteti / Shteti		Kutia Postare
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit		
Telefon	Fax	E-mail

Në kategorinë e shërbimit të informacionit(Directory Enquiry Access Code) të Planit Kombëtar të Numeracionit, caktohet për përdorim kodi i shkurtër:

118 X₁X₂

ku:

- 118 - kodi i aksesit për shërbimin e marrjes së informacionit, i harmonizuar në nivel evropian;
- X₁X₂ - është numri identifikues i sipërmarrësit që ofron shërbimin.

Është e ndaluar të ofrohen shërbime të tjera me Vlerë të Shtuar përveç atyre për numeratorin telefonik.

K R Y E T A R I



ANEKSI 9

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM NUMERACIONI

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
Adresa Postare		Data e Regjistrimit ne QKR
		/ /
Qyteti / Shteti		Kutia Postare
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit		
Telefon	Fax	E-mail

Në kategorinë e "Shërbimit Internet"(dial-up) në Planin Kombëtar të Numeracionit, caktohet për përdorim kodi i shkurtër:

(0) 717 Y₁Y₂Y₃ Z

ku:

- 0 - prefiksi kombëtar
- 717 - që formohet pas prefiksit kombëtar "0" identifikon Kodin e Drejtimit Kombëtar (NDC) të harmonizuar për shërbimet Internet, Transmetim të Dhënash dhe Videotekst;
- Y₁Y₂Y₃ - Numri Identifikues i Subjektit;
- Z - identifikon llojin e shërbimit Internet ndër shërbimet e përfshira në kodin "717".

K R Y E T A R I



ANEKSI 10

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM TË KODIT TË PIKËS KOMBËTARE TË SINJALIZIMIT (NSPC)

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
Adresa Postare		Data e Regjistrimit ne QKR
		/ /
Qyteti / Shteti		Kutia Postare
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit		
Telefon	Fax	E-mail

1. Vlerat numerike të Kodit të Pikës Kombëtare të Sinjalizimit -NSPC(National Signalling Point Code) sipas formateve decimal(D`), hexadecimal(H`) dhe binary to decimal (3-4-7):

Kodi i Pikës Kombëtare të Sinjalizimit(NSPC) sipas formateve:			Emri i Pikës së Sinjalizimit
Decimal (D`)	Hexadecimal (H`)	Binary to Decimal (3-4-7)	

2. Kodi i treguesit te Rrjetit NI=**10**(binar) ose NI=**2**(decimal).
3. Implementimi dhe perdorimi i këtij kodi të bëhet në formatin binar 3-4-7 (14 bit) dhe në përputhje me “Rregullat për Administrimin e Kodeve të Pikave të Sinjalizimit Kombëtare dhe Ndërkombëtare” (VKD Nr.1257, datë 16.04.2010 i AKEP).

K R Y E T A R I



ANEKSI 11

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM TË KODIT TË PIKËS NDËRKOMBËTARE TË SINJALIZIMIT (ISPC)

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
Adresa Postare		Data e Regjistrimit ne QKR
		/ /
Qyteti / Shteti		Kutia Postare
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit		
Telefon	Fax	E-mail

1. Vlera numerike e Kodit te Pikës Ndërkombëtare të Sinjalizimit-ISPC(International Signalling Point Code) sipas formatit binar (3-8-3):

Kodi i Pikes Ndërkombëtare të Sinjalizimit(ISPC) sipas formatit(3–8–3)	Emri i Pikës së Sinjalizimit

2.Kodi i treguesit të Rrjetit NI=00(binari) ose NI=0(decimal).

3.Implementimi dhe përdorimi i ketij kodi të bëhet në formatin binar 3-8-3 (14 bit) dhe në përputhje me “Rregullat për Administrimin e Kodeve të Pikave të Sinjalizimit Kombëtare dhe Ndërkombëtare” (VKD Nr.1257, date 16.04.2010 i AKEP) dhe Rekomandimin Q.708 (03/99) të ITU-T.

K R Y E T A R I



ANEKSI 12

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM TË KODIT TË RRUGËZIMIT PËR PORTABILITETIN E NUMRIT

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
Adresa Postare		Data e Regjistrimit ne QKR
		/ /
Qyteti / Shteti		Kutia Postare
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit		
Telefon	Fax	E-mail

1.Vlera numerike e Prefiksit të Rrugëzimit për Portabilitetin e Numrit:

99 X₁X₂

ku:

- 99 - kodi i aksesit për portabilitetin e numrit,
- X₁X₂ - është numri identifikues i sipërmarresit që ofron shërbimin.

2.Implementimi dhe përdorimi i këtij kodi të bëhet në përputhje me “Rregulloren për Portabilitetin e Numrit” (VKD Nr.1219, datë 07.04.2010 i AKEP).

KRYETARI



ANEKSI 13

PËR CAKTIM DHE PËRDORIM TË PREFIKSIT PËR ZGJEDHJEN E BARTËSIT

Emri i Personit Fizik/Juridik		NIPT-i
Adresa Postare		Data e Regjistrimit ne QKR
		/ /
Qyteti / Shteti		Kutia Postare
Telefon	Fax	E-mail
Personi i Kontaktit		
Telefon	Fax	E-mail

1. Vlera numerike e Prefiksit për zgjedhjen e Bartësit:

10 X₁X₂

ku:

- 10 - kodi i aksesit për zgjedhjen e bartësit,
- X₁X₂ - është numri identifikues i sipërmarresit që ofron shërbimin.

2. Implementimi dhe përdorimi i këtij kodi të bëhet në përputhje me “Rregulloren për Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike” (VKD Nr.932, datë 11.08.2009 i AKEP).

K R Y E T A R I

NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR.10, PËR “CAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE” TË MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT DREJTUES TË AKEP NR. 932 DATË 11.08.2009, E NDRYSHUAR ME VKD NR. 2394, DATË 05. 12. 2013.

Miratuar me VKD Nr.2631, date 29.10.2015

Neni 3

Përkufizime

Pika 1, Facilitete shoqëruese”

ishte:

“Facilitete shoqëruese” janë facilitetet e lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike dhe/ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti ose shërbimi.

bëhet:

“Facilitete shoqëruese” janë ato shërbime shoqëruese, infrastruktura fizike dhe facilitete të tjera ose elemente të lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike dhe/ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë dhe/ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti dhe/ose shërbimi ose kanë potencial për ta bërë këtë, e që përfshijnë, ndërmyjet të tjerash, ndërtesat ose hyrjen në ndërtesa, kabllot e ndërtesave, antenat, kullat dhe ndërtime të tjera mbështetëse, kanalizime, tubacione, shtylla, puseta dhe kabinete.

Pika 2

“Identifikimi i linjës thirrëse”

ishte:

“Identifikimi i linjës thirrëse” është funksioni që, në bazë të numrit ose kodit të caktuar për pikën fundore të rrjetit, i mundëson pajtimtarit marrës të thirrjes të identifikojë pikën fundore të rrjetit, ku është origjinuar thirrja.

bëhet:

“Identifikimi i linjës thirrëse” është funksioni që, në bazë të numrit ose kodit të caktuar për pikën fundore të rrjetit, i mundëson pajtimtarit marrës të thirrjes të identifikojë pikën fundore të rrjetit, ku ka pikënisjen thirrja.

Miratuar me VKD Nr.2631, date 29.10.2015

Shtohet pika 3 me kete permbajtje:

“Identifikimi i linjës së thirrur” është funksioni, që lejon dërguesin e thirrjes të identifikojë pikën fundore të rrjetit, ku përfundon thirrja, bazuar në numrin ose kodin që i është caktuar kësaj pike fundore të rrjetit.

Pika 6

ishte

“Numër gjeografik” është një numër kombëtar, i cili i përket një zone gjeografike të caktuar.

bëhet pika 7 si më poshtë:

“Numër gjeografik” është një numër kombëtar, i cili i përket një rajoni gjeografike të caktuar.

Pika 7

ishte

“Numrat jo-gjeografikë” janë numrat kombëtarë, që nuk i përkasin një zone gjeografik të caktuar dhe përfshijnë:

bëhet pika 8 si më poshtë:

“Numrat jo-gjeografikë” janë numrat kombëtarë, që nuk i përkasin një rajoni gjeografik të caktuar dhe përfshijnë:

Shtohet pika 14 si më poshtë:

“Përdorues” është cilido që përdor ose kërkon të përdorë shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun.

Pika 21

ishte:

“Shërbim i komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun” është shërbimi, normalisht përkundrejt një pagese, i cili përftohet, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike;

bëhet pika 24 si më poshtë:

“Shërbim i komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun” është shërbimi i komunikimeve elektronike, nga përdorimi i të cilit asnjë person nuk është, paraprakisht, i përjashtuar.

Pika 26 bëhet:

“Shërbim publik telefonik i lëvizshëm tokësor” është shërbimi publik telefonik, i ofruar për përdoruesit, nëpërmjet një rrjeti publik telekomunikacionesh pikat fundore të të cilit nuk janë në vendndodhje të qëndrueshme, duke u dhënë mundësi përdoruesve të komunikojnë brenda zonave të mbuluara nga ky shërbim, pavarësisht nga vendndodhja.

Pika 27 bëhet:

“Shërbim publik telefonik i qëndrueshëm (i palëvizshëm)” është shërbimi publik telefonik, i ofruar për përdoruesit, pajisjet fundore të të cilëve lidhen në pikat fundore me vendndodhje të qëndrueshme të rrjetit publik të telekomunikacioneve.

Gërma b) e pikës 5 shfuqizohet.

Neni 10

Numrat e urgjencës (112, 12X, ku $X=5 \div 9$)

Pika 2 b) ishte:

b) numri **125 i lire**

bëhet:

b) numri **125** për emergjencat detare

Pika 2 e Neni 6- Struktura e planit të numeracionit ishte:

Plani numërformimit është një plan i hapur. Përdoruesit përdorin gjithmonë prefiksin kombëtar “0”, përveç se kur thërrasin kode të shkurtër që fillojnë me “1” ose destinacionet lokale në të njëjtën zonë gjeografike. Plani i numërformimit përmban kategoritë e mëposhtme të numrave:

- a) prefiksi kombëtar : 0;
- b) prefiksi ndërkombëtar: 00;
- c) prefikset për zgjedhjen e bartësit:

10 X1 X2 (ku: $X1, X2=0 \div 9$)

- a) kodet e rrugëzimit për portabilitetin e numrit:
99 X1 X2 (ku: X1, X2=0 ÷ 9)

Bëhet:

Plani numërformimit është një plan i mbyllur. Përdoruesit përdorin gjithmonë prefiksin kombëtar “0”, përveç se kur thërrasin kode të shkurtër që fillojnë me “1”. Plani i numërformimit përmban kategoritë e mëposhtme të numrave:

- a) prefiksi kombëtar : **0**;
- b) prefiksi ndërkombëtar: **00**;
- c) prefikset për zgjedhjen e bartësit:

10 X1 X2 (ku: X1, X2=0 ÷ 9)

- a) kodet e rrugëzimit për portabilitetin e numrit:

99 X1 X2 (ku: X1, X2=0 ÷ 9)

Nenit 23- Plani i numërformimit

Pika 3 ishte:

Për thirrjet nga një numër gjeografik tek një numër tjetër gjeografik, brenda të njëjtës zone gjeografike, përdoruesi i numrit gjeografik mund të formojë:

- a) vetëm numrin e pajtimtarit të palës së thirrur duke përdorur prefiksin kombëtar të thirrjes 0 para numrit të plotë kombëtar. (thirrje lokale), ose
- b) prefiksin kombëtar 0, kodin e destinacionit kombëtar(NDC) dhe numrin e pajtimtarit të palës së thirrur(SN).

Të gjithë operatorët që mbështesin thirrjet nga numrat gjeografikë në numra të tjerë gjeografikë duhet t’u ofrojnë përdoruesve të tyre të dyja menyrat e thirrjes së numrave gjeografikë. Kjo dispozitë nuk parashikon formatin e përdorur për interkoneksion. Nëse përdoruesi formon një numër në një format që nuk e mbështet interkoneksioni, operatori duhet ta konvertojë në formatin e duhur para dërgimit në pikën e interkoneksionit.

Bëhet:

Për thirrjet nga një numër gjeografik tek një numër tjetër gjeografik, brenda rajonit gjeografik, përdoruesi i numrit gjeografik duhet të formojë:

- a) numrin e pajtimtarit të palës së thirrur duke përdorur prefiksin kombëtar të thirrjes **0** para numrit të plotë kombëtar.

Gërma b) e pikës 6 ishte:

për thirrjet kombëtare (përvec thirrjeve lokale): prefiksin për përzgjedhjen e bartësit (10XX), prefiksin e thirrjes kombëtare (0) dhe numrin e plotë kombëtar;

bëhet:

për thirrjet kombëtare: prefiksin për përzgjedhjen e bartësit (**10XX**), prefiksin e thirrjes kombëtare (**0**) dhe numrin e plotë kombëtar;

Gërma c) e pikës 6 shfuqizohet